

FINANCAT PUBLIKE VENDORE NË SHQIPËRI

Status Raport 2019



Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

"Ky publikim është produkt i Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habitatit në kuadër të projektit "Financat Vendore dhe Perceptimi i Qytatarëve mbi Shërbimet Vendore" me mbështetjen financiare të LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. Opinionet dhe konkluzionet e këtij publikimi i përkasin autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC."

FINANCAT PUBLIKE VENDORE
www.financatvendore.al

Co-PLAN
INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT
INSTITUTI PER ZHVILLIMIN E HABITATIT

FINANCAT PUBLIKE VENDORE NË SHQIPËRI

Status Raport 2019

Financuar nga LevizAlbania

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Tabela e përmbajtjes

Listë grafikë.....6

Listë tabela.....8

Listë hapësira informuese.....8

Shënim metodologjik.....10

1. Hyrje.....12

2. Burimet financiare totale për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave.....13

2.1 Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore.....18

2.1.1 Të ardhurat nga taksat vendore.....24

2.1.2 Të ardhurat nga tarifat vendore.....34

2.1.3 Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura 36

2.2 Të ardhurat nga taksat e ndara.....40

2.3 Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale.....41

2.4 Të ardhurat nga transferta e kushtëzuar.....44

2.5 Burimet financiare: sa para patën në dispozicion bashkitë në vitin 2019?.....46

3. Shpenzimet vendore: si i përdorën bashkitë paratë në dispozicion?.....50

3.1 Shpenzimet sipas burimit të financimit.....53

3.2 Shpenzimet e kryera me fonde të veta të bashkive.....56

3.2.1 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit ekonomik.....57

3.2.2 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional. 63

3.3 Shpenzimet e kryera me fonde nga transferta të kushtëzuara 67

3.4 Kosto e qeverisjes vendore në fund të vitit 2019.....70

4. Përfundime.....75

Shtojca.....78

Shënime.....84

Listë grafikë

Grafik 1. Treguesit e të ardhurave ndaj PBB-së.....15
Grafik 2. Tregues të tërthortë të autonomisë fiskale vendore.....16
Grafik 3. Norma vjetore e rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore, viti 2019.....17
Grafik 4. Rëndësia e të ardhurave nga burime të veta në buxhetin vendor.....18
Grafik 5. Ecuria e të ardhurave nga burime vendore (në vlerë dhe nd. vjetore)..... .19
Grafik 6. Të ardhura nga burime të veta vendore: kontribute (në p.p.) dhe ndryshimi vjetor (në %).....20
Grafik 7. Përbërja e të ardhurave nga burime të veta sipas bashkive.....22
Grafik 8. Ecuria e të ardhurave nga taksat vendore.....24
Grafik 9. Të ardhurat nga taksat vendore sipas zërave kryesorë.....25
Grafik 10. Të ardhurat taksa mbi pasurinë e paluajtshme.....26
Grafik 11. Të ardhurat taksa mbi pasurinë e paluajtshme (sipas bashkive).....26
Grafik 12. Të ardhura nga taksat mbi ndërtesën dhe tokën bujqësore.....27
Grafik 13. Ecuria e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.....28
Grafik 14. TNI, bashkitë ndaj mesatares kombëtare për vitin 2019.....30
Grafik 15. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total = 100%).....31
Grafik 16. Ecuria e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.....32
Grafik 17. Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier.....33
Grafik 18. Performanca e zërave kryesorë të tarifave vendore.....34
Grafik 19. Borxhi publik përkundrejt kriterit të Mastriktit.....37
Grafik 20. Stoku i detyrimeve të prapambetura (në miliardë lekë).....38
Grafik 21. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas bashkive.....39
Grafik 22. Të ardhura nga taksat e ndara..... 40
Grafik 23. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar ndër vite.....42
Grafik 24. Varësia nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike, viti 2018.....43
Grafik 25. Të ardhura nga transfertat e kushtëzuara.....44
Grafik 26. Ecuria e burimeve financiare totale.....46

Grafik 27. Kontributi i kategorive (në pikë përqindje) në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në përqindje).....47
Grafik 28. Burimet financiare sipas bashkive viti 2019..... 48
Grafik 29. Tregues të shpenzimeve vendore..... 51
Grafik 30. Investimet ndaj PBB-së nominale.....52
Grafik 31. Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve (viti 2019).....53
Grafik 32. Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit.....54
Grafik 33. Mbulimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale sipas burimit.....54
Grafik 34. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional dhe burimit të financimit.....55
Grafik 35. Ecuria e shpenzimeve me fonde të veta.....56
Grafik 36. Kontributi sipas kategorive në shpenzimet me fonde të veta.....57
Grafik 37. Shpenzimet me fonde të veta sipas natyrës ekonomike.....58
Grafik 38. Shpenzimet operative sipas zërave.....59
Grafik 39. Prirja e shpenzimeve kapitale me fonde të veta.....60
Grafik 40. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike për 61 bashki (total = 100%), viti 2019.....62
Grafik 41. Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional.....63
Grafik 42. Indeksi i shpenzimeve me fonde të veta (bashkitë përkundrejt mesatares afatgjatë).....66
Grafik 43. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara.....68
Grafik 44. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas natyrës ekonomike.....69
Grafik 45. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas funksioneve të qeverisjes.....69
Grafik 46. Përdorimi i burimeve financiare totale.....70
Grafik 47. Shpërndarja e të punësuarve sipas bashkive (numër të punësuar).....72
Grafik 48. Të punësuar në bashki për 1,000 banorë.....73

Listë tabela

Tabelë 1. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në lekë).....35
Tabelë 2. Huamarrja vendore.....36
Tabelë 3. Burime financiare sipas kategorive (në lekë).....47
Tabelë 4. Shpenzimet me fonde të veta për frymë, në lekë.....78
Tabelë 5. Shpenzimet kapitale me fonde të veta për frymë, në lekë.....80
Tabelë 6. Të ardhura nga burime të veta vendore për frymë.....82

Listë hapësira informuese

Hapësirë informuese 1. Si u ndikuan bashkitë nga fatkeqësitë natyrore
të fund-vitit 2019?.....16
Hapësirë informuese 2. Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas
bashkive.....20
Hapësirë informuese 3. Detyrimet e prapambetura: sa rëndojnë në
buxhetet e bashkive?.....38
Hapësirë informuese 4. Tregues të autonomisë financiare vendore.....48
Hapësirë informuese 5. Si shpenzuan 61 bashkitë në vitin 2019?.....60
Hapësirë informuese 6. Shpenzimet me fonde të veta: si paraqiten bashkitë?.....65
Hapësirë informuese 7. Shpenzimet e personelit dhe numri i të punësuarve në
61 bashki.....71

SHËNIM METODOLOGJIK

Burimi i të dhënave për njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë (bashkitë) është Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit, SIFQ) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë përpunuar dhe më pas publikuar në platformën www.financatvendore.al.[1] Të dhënat janë kumulative (ose stok në fund të periudhës), të shprehura në monedhë vendase (lekë) dhe u referohen vetëm 61 bashkive (12 qarqet nuk janë të përfshirë në analizë). Për të mundësuar krahasimet historike me periudhën përpara zbatimit të reformës administrative dhe territoriale (RAT), të dhënat për periudhën 2010-2015 për 373 njësi të vetëqeverisjes vendore u ri-klasifikuan në nivelin e 61 bashkive të reja të krijuara në vijim të RAT.

Për qëllime analize të dhënat e marra nga SIFQ në formë bruto janë klasifikuar nga autorët duke ndjekur gjerësisht përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe praktikën ndërkombëtare përkatëse.[2] Të dhënat për të ardhurat janë kategorizuar në përputhje me sa lartpërmendur në:

- të ardhura nga burime të veta vendore që përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, tarifat, huamarrje vendore dhe të tjera;
- taksa të ndara sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- transferta të pakushtëzuara dhe specifike; dhe
- transferta të kushtëzuara nga ministritë e linjës për funksione të deleguara.

Tre kategoritë e para janë klasifikuar nën emërtimin e përbashkët të *burimeve financiare të disponueshme*, burime mbi të cilat bashkitë kanë të drejta vendimmarrjeje relative në lidhje me mënyrën e përdorimit. Ndërsa, mbi kategorinë e transfertave të kushtëzuara, bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrje në lidhje me sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve; pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, me destinacion të përcaktuar). Për simetri me mënyrën e organizimit të të dhënave mbi të ardhurat sipas burimit, analiza e shpenzimeve do të organizohet në dy kategori kryesore:

- shpenzime të kryera me fonde të veta të bashkive (ku përfshihen të ardhurat nga burimet e veta, taksat e ndara, transferta e pakushtëzuar dhe specifike) dhe,
- shpenzime të kryera me fonde të kushtëzuara (ku do të përfshihen ato kategori shpenzimesh të mbuluara me fonde nga transferta të kushtëzuara nga ministritë e linjës, përfshirë fondet për investime nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)).

Për të dy kategoritë, si me fonde të veta ashtu dhe me fonde të kushtëzuara, shpenzimet do të paraqiten sipas natyrës ekonomike të tyre (korrente dhe kapitale) dhe sipas funksioneve të qeverisjes vendore (COFOG).

Ky raport është pjesë e një serie raportesh me frekuencë tremujore dhe vjetore për financat vendore të përgatitur nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Raportet e mëparshme mund të gjenden në: http://www.financatvendore.al/pub/raporte.

Për një panoramë të përgjithshme për secilën prej 61 bashkive, mund të konsultoni Profilet e Bashkive në: http://www.financatvendore.al/analiza/profilet.

1. HYRJE

Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në financat publike vendore është një hap i rëndësishëm në vlerësimin e kapacitetit financiar të tyre në funksion të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjithashtu, një kuptim më i mirë i raportit kompetenca – burime financiare të disponueshme informon hartimin e politikave efektive dhe eficiente në qeverisjen vendore, lehtëson dialogun ndërmjet niveleve të qeverisjes, informon mbi kapacitetet huamarrëse, përmirëson llogaridhënien, transparencën dhe besimin e komunitetit në përfaqësuesit vendorë.

Status raporti i financave vendore ka për qëllim të paraqesë një panoramë të përgjithshme të financave publike vendore për 61 bashkitë, në fund të vitit 2019. Performanca financiare e bashkive në kahun e të ardhurave dhe në shpërndarjen e tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve publike përbën një moment të rëndësishëm në fund të reformave decentralizuese të ndërmarra përgjatë katër viteve të fundit (RAT,3 SNDQV 2015-2020, etj.), zhvillimin e zgjedhjeve vendore në muajin qershor 2019 dhe nën presionin e shtuar mbi bashkitë në vijim të fatkeqësive natyrore si tërmeti i shtatorit dhe 26 nëntorit 2019. Gjithashtu, ecuria e financave publike vendore do të analizohet gërshetuar me informacione nga burime të tjera (Instat, Ministria e Financave dhe Ekonomisë etj.) me qëllim paraqitjen e faktorëve që mund të kenë kontribuar në ecurinë e treguesve për të ardhurat dhe shpenzimet vendore.

Status Raporti i Financave Publike Vendore për Vitin 2019, paraqet në kapitullin e dytë një analizë të detajuar të ecurisë së burimeve financiare vendore sipas kategorive; në kapitullin e tretë trajtohen shpenzimet e kryera nga qeverisja vendore me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara, ndërthurur me natyrën ekonomike dhe funksionale të shpenzimeve. Në vijim, disa rezultate dhe rekomandime për të ardhmen.

2. BURIMET FINANCIARE TOTALE PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE DHE KOMPETENCAVE



Bashkitë, përfaqësojnë nivelin e qeverisjes më pranë qytetarëve dhe si të tilla, potencialisht janë në gjendje të adresojnë më mirë qe qeveria qendrore nevoja e komuniteteve që ato përfaqësojnë. Bazuar në përparësitë informative që bashkitë gëzojnë përkundrejt qeverisjes vendore, oferta për të mira dhe shërbime publike mund të përshtatet potencialisht me nevojat – preferencat e qytetarëve. Reformat decentralizuese të ndërmarra në Shqipëri përgjatë periudhës 2015 – 2018 gjerësisht synuan fuqizimin e qeverisjes vendore, duke krijuar kushtet dhe kapacitetet për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me cilësi dhe eficiencë.4 Në terma sasiorë, rëndësia e qeverisjes vendore në qeverisjen e përgjithshme vlerësohet të jetë rritur bazuar në ecurinë e treguesit të burimeve financiare totale të bashkive ndaj PBB-së nominale dhe treguesit të burimeve financiare të disponueshme ndaj PBB-së nominale për periudhën 2015-2018. Viti 2019 shënoi dy momente të rëndësishme: zgjedhjet vendore të muajit qershor dhe fatkeqësitë natyrore të muajve shtator dhe dhjetor. Këto të fundit, patën pasoja të rënda në jetën e komuniteteve, në jetë njerëzish dhe dëme materiale të mëdha në struktura, pasojat e të cilëve pritet të jenë më të ndjeshme në buxhetet vendore përgjatë vitit 2020.

Të dhënat tregojnë se treguesit e të ardhurave për qeverisjen vendore (nga burime të veta vendore, të disponueshme dhe totale) në raport ndaj PBB-së, pas një ecurie me luhatje minimale gjatë viteve 2010-2015, në tre vitet në vijim (deri në fund të vitit 2018) ndoqën prirje rritëse diktuar nga faktorë të ndryshëm si, shtimi i funksioneve të reja dhe përgjegjësive për të shpenzuar,5 përdorimi i agjentëve tatimorë të UK-ve për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore dhe ndryshime të politikës fiskale të bashkive (rritja e taksave dhe tarifave vendore në disa bashki).

Treguesi i të ardhurave nga burime të veta vendore ndaj PBB-së nominale rezulton të jetë rritur nga 0.9% në vitin 2015 në rreth 1.5% në fund të vitit 2019. Ky përmirësim vlerësohet të jetë ndikuar veçanërisht prej rritjes së të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja (TNI), e cila në masën më të madhe gjenerohet në bashkinë Tiranë.

Treguesi i të ardhurave të disponueshme ndaj PBB-së nominale gjithashtu rezulton të jetë përmirësuar nga viti në vit duke shënuar një nivel prej rreth 3.1% në fund të vitit 2019 nga rreth 1.8% që vlerësohej në vitin 2015. Zhvillimet në kahun përmirësues në këtë tregues vlerësohet të jenë përcaktuar gjerësisht nga stabilizimi dhe rritja e nivelit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale.

Përmirësimi nominal i treguesve që përfshijnë kategoritë e të ardhurave nga burime të veta dhe ato nga transfertat ndërqeveritare të pakushtëzuara duket të jetë kundërbilancuar nga zhvillimet në transfertat e kushtëzuara (rënia e tyre në vitin 2019). Kështu, treguesi i burimeve financiare totale ndaj PBB-së nominale, pas përmirësimit dhe të vlerës më të lartë historike të shënuar në vitin 2018, u moderua në rreth 4.8% në fund të vitit 2019.

Grafik 1. Treguesit e të ardhurave ndaj PBB-së



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në të njëjtën linjë me treguesit e lartpërmendur, treguesit e autonomisë fiskale vendore (matur nga raporti i të ardhurave nga burime të veta vendore ndaj burimeve totale dhe raporti i burimeve të disponueshme ndaj burimeve totale) rezultojnë të jenë përmirësuar në fund të vitit 2019, në terma vjetorë dhe krahasuar me mesataren afatgjatë. Raporti i të ardhurave nga burimet e veta vendore ndaj totalit të burimeve financiare shënoi një nivel prej rreth 31.4% në fund të vitit 2019, në rritje me rreth 2.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Ngjashëm, raporti i burimeve financiare të disponueshme ndaj burimeve financiare totale shënoi rritje me rreth 4.4 pikë përqindje në terma vjetorë, duke regjistruar një nivel prej rreth 63.7% në vitin 2019. Përmirësimi i treguesve të autonomisë fiskale gjykohet të jetë ndikuar gjerësisht prej zgjerimit të të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale.

Grafik 2. Tregues të tërthortë të autonomisë fiskale vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Hapësirë informuese 1
Si u ndikuan bashkitë nga fatkeqësitë natyrore të fund vitit 2019?

Viti 2019 shënoi dy ngjarje me rëndësi për bashkitë: zgjedhjet vendore të mbajtura në muajin qershor dhe fatkeqësitë natyrore të muajve shtator dhe nëntor efektet e të cilëve u ndjenë në rreth 11 bashki si: Tiranë, Durrës, Lezhë, Kurbin, Krujë, Kavajë, Kamëz, Peqin, Rrogozhinë, Shijak dhe Vorë. Në mënyrë të veçantë, fatkeqësitë natyrore të ndodhura në gjysmën e dytë të vitit 2019, vlerësohet të kenë ndikuar në frenimin e përgjithshëm të ekonomisë në vend dhe ngadalësimin e ritmit të rritjes të të ardhurave nga burime të veta vendore. Megjithatë, vlerësimi paraprak i efekteve të tyre në financat e bashkive (të ardhurat nga burimet e veta vendore) të prekura nuk duket të jetë materializuar ende plotësisht. Të ardhurat nga burimet e veta vendore, vlerësohet të jetë kategoria e cila do të prekej drejtpërdrejt nga këto ngjarje në disa prej zërave të saj: taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier, taksa e pronës, tarifat vendore (mbi zënien dhe përdorimin e hapësirave publike, tarifat e shërbimeve) etj. Në vitin 2019, të ardhurat nga burimet e veta vendore rezultojnë në rritje për bashkitë: Lezhë (+67.3%), Peqin (+37.7%) dhe Shijak (+14.4%). Në rritje me ritme më të moderuara rezultojnë të ardhurat në bashkitë: Rrogozhinë (+6.6%), Tiranë (+6.1%), Kavajë (+3%), Kamëz (+1.4%) dhe Durrës (+1.2%). Në të kundërt, të ardhurat nga burime të veta vendore shënuan rënie në bashkitë Krujë (-4.8%), Vorë (-4.4%) dhe Kurbin (-0.4%).

Grafik 3. Norma vjetore e rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore, viti 2019



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Zhvillimet e ndodhura në vitin 2019, për bashkitë e konsideruara, duket të mos kenë kushtëzuar ndjeshëm të ardhurat nga burimet e veta vendore, krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, vlerësohet se efektet mbi të ardhurat nga burimet e veta vendore do të jenë më të ndjeshme përgjatë vitit 2020.

2.1 | ECURIA E TË ARDHURAVE NGA BURIMET E VETA VENDORE

Të ardhurat nga burimet e veta vendore janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Në buxhetin vendor, kjo kategori të ardhurash përfaqësoi rreth 31.4% ndaj burimeve financiare totale në vitin 2019. Krahasuar me një vit më parë, ky raport shënoi një përmirësim të lehtë me rreth 2.2 pikë përqindjeje dhe qëndron rreth 5.0 pikë përqindjeje mbi mesataren afatgjatë.6 Në këtë përmirësim vlerësohet të kenë ndikuar një sërë faktorësh, si rritja e nivelit të taksave dhe tarifave vendore në disa prej bashkive dhe përmirësimi i mundshëm në normën e mbledhjes së të ardhurave (duke përdorur si agjentë tatimorë ndërmarrjet e UK-ve).

Grafik 4. Rëndësia e të ardhurave nga burime të veta në buxhetin vendor



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në terma nominalë, në fund të vitit 2019 të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asete dhe të tjera) regjistruan një vlerë prej rreth 25.6 miliard lekë, në rritje me rreth 5.5% në terma vjetorë, ose rreth 1.4 miliard lekë më të larta nga niveli i regjistruar vitin e mëparshëm. Norma e rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore rezulton të jetë moderuar ndjeshëm në vitin 2019, krahasuar me normën e rritjes së tyre në tre vitet e mëparshme. Ky ngadalësim vlerësohet të jetë përcaktuar gjerësisht nga ecuria e të ardhurave nga burime të veta vendore në bashkinë Tiranë, si bashkia me peshën më të madhe në totalin e kësaj kategoria të ardhurash.7 Duke përjashtuar bashkinë Tiranë, norma vjetore e rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore u moderua në rreth 4.8% në fund të vitit 2019.

Nëse do të hidhnim një vështrim historik mbi ecurinë e të ardhurave nga burimet e veta vendore përgjatë periudhës 2010-2019, duke përjashtuar bashkinë Tiranë, do të vëmë re se kjo kategori të ardhurash ka ndjekur prirje rritëse por me ritme të përmbajtura. Shtuar bashkinë Tiranë, të ardhurat e kësaj kategorie regjistrojnë norma rritëse dy-shifrore. Ndaj, vlerësohet se performanca e të ardhurave nga burime të veta vendore përcaktohet gjerësisht nga bashkia Tiranë.

Grafik 5. Ecuria e të ardhurave nga burime vendore (në vlerë dhe nd. vjetore)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Gjatë vitit 2019, performanca e të ardhurave nga burime të veta është përcaktuar gjerësisht nga kontributi i të ardhurave nga taksat vendore me rreth 5.5 pikë përqindjeje. Të ardhurat nga taksat vendore vijojnë të kontribuojnë pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave vendore për të katërtin vit radhazi, ndonëse kontributi i tyre u tkurr nga rreth 16.2 pikë përqindjeje në vitin 2017 dhe në rreth 9.6 pikë përqindjeje në vitin 2018, dhe rreth 5.5 pikë përqindjeje në fund të vitit 2019. Të ardhurat nga tarifat vendore kontribuuan negativisht me rreth -0.5% pikë përqindjeje në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga burime të veta vendore për vitin 2019.

Grafik 6. Të ardhura nga burime të veta vendore: kontribute (në p.p.) dhe ndryshimi vjetor (në %)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Luhatshmëria në terma të kontributit në kohë i kategorive të të ardhurave nga burimet e veta vendore, vlerësohet të jetë ndikuar nga ndërhyrjet e shpeshta në kuadrin legjislativ për ndryshimin e nivelit dhe bazës së taksueshme për taksat dhe tarifat vendore (si p.sh. në rastin e taksës mbi aktivitetin e biznesit të vogël/tatimi thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, ndryshimet në taksën e pronës, rritja apo ulja e tarifave vendore etj.) apo ndryshime në elementë të tjerë të administrimit të tyre (si p.sh. përdorimi i agjentëve tatimorë si UK për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore).

Hapësirë informuese 2

Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas 61 bashkive

Roli i të ardhurave nga taksat, tarifat dhe burimet e tjera vendore në buxhetin vendor ndryshon ndjeshëm ndërmjet 61 bashkive në vend, duke sugjeruar për një strukturë të ndryshme të taksapaguesve në secilën prej bashkive si dhe ndryshueshmëri në zhvendosjen e barrës fiskale ndër ta, qofshin familjarë apo biznese. Për rreth 41% të bashkive (25 nga 61 bashki) të ardhurat nga taksat përfaqësojnë mbi 50% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Bashkitë Vorë, Pustec, Tiranë, Shijak, Roskovec, Peqin, Lezhë, Klos, Kavajë, dhe Fier mbledhin të ardhura nga taksat vendore mbi mesataren kombëtare prej rreth 61.8%. Në bashkinë Vorë, të ardhurat

nga taksat vendore përfaqësojnë rreth 81.9% të të ardhurave totale nga burimet e veta vendore, ndikuar kryesisht nga prania e një numri të lartë biznesesh në territor. Në të kundërt, të ardhurat nga taksat vendore zënë peshën më të ulët në bashkinë Pukë, me rreth 18.8% ndaj totalit të të ardhurave nga burimet vendore. Ndërsa, për rreth 47.5% të bashkive (29 nga 61 bashki) janë të ardhurat nga tarifat të cilat përfaqësojnë mbi 50% e këtyre nga burimet e veta vendore të bashkisë. Në bashkitë Gramsh, Has, Mallakastër, Kamëz, Pukë dhe Skrapar tarifat vendore kontribuojnë me më shumë se 70% në të ardhurat nga burimet e veta vendore të bashkisë.

Kapaciteti i bashkive për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore, paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive (në linjë me karakteristikat në terma të popullsisë rezidente dhe bizneseve të lokalizuara në territor): rreth 61.7% e të ardhurave totale nga taksat vendore mblidhet në bashkinë Tiranë, ndjekur nga bashkia Durrës me rreth 4.6%. Panoramë e ngjashme paraqitet edhe në rastin e të ardhurave nga tarifat vendore: bashkia Tiranë mbledh rreth 43.6% të totalit, ndjekur nga bashkitë Kamëz dhe Durrës me 5.1% dhe 5%, përkatësisht. Praktikisht, pesha e bashkive ndaj totalit të të ardhurave si nga taksat ashtu dhe nga tarifat vendore, sugjeron për një hendek të madh në terma të kapaciteteve fiskale ndërmjet bashkisë Tiranë dhe 60 bashkive të tjera. Përjashtuar bashkinë Tiranë, diferencat mes bashkive zbuten ndjeshëm dhe janë të pranishme në nivel më të moderuar ndërmjet bashkive qendra qarku (bashkitë e mëdha) dhe 49 bashkive të tjera. Diferencat e theksuara midis bashkive në terma të kapaciteteve fiskale parashtrojnë nevojën për instrumente kompensues apo zbutës të tyre, për të lejuar përmbushjen e funksioneve apo ofrim të shërbimeve publike, në sasi dhe cilësi.

Grafik 7. Përbërja e të ardhurave nga burime të veta sipas bashkive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Taksa
Tarifa
Të tjera
Librazhd
Lushnjë
Malësi e Madhe
Maliq
Mallakaster
Mat
Memaliaj
Mirditë
Patos
Peqin
Përmet
Pogradec
Poliçan
Prrenjas
Pukë
Pustec
Roskovec
Rrogozhinë
Sarandë
Selenicë
Shijak
Shkodër
Skrapar
Tepelenë
Tiranë
Tropojë
Ura_Vajgurore
Vau I Dejës
Vlorë
Vorë

2.1.1 | TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm financiar në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore të bashkive. Në terma nominalë, të ardhurat nga taksat vendore kontribuan me rreth 15.9 miliardë lekë në buxhetin vendor, në rritje me rreth 9.1% krahasuar me një vit më parë. Norma e rritjes së të ardhurave nga taksat vendore mbetet e pandryshuar, edhe nëse nga totali i tyre do të zbrisnim të ardhurat e mbledhura në bashkinë Tiranë. Pesha e këtij zëri ndaj totalit të të ardhurave nga burime të veta vendore ishte rreth 62.4%, raport ky rreth 2.2 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (prej rreth 64.1%).

Grafik 8. Ecuria e të ardhurave nga taksat vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndonëse në terma të përgjithshëm të ardhurat nga taksat vendore rezultojnë të kenë shënuar zhvillime pozitive, një vështrim i hollësishëm mbi elementët përbërës evidenton dobësitë afatgjata apo varësinë ndaj një numri të kufizuar taksash. Në tre vitet e fundit, performanca e të ardhurave nga taksat vendore është përcaktuar nga dy elementë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksat mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa, tokë bujqësore, truall). Ndërkohë që pesha e kësaj të fundit është tkurrur, pesha e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime te reja është rritur me ritme të përshpejtuara. Në vitin 2019, këto dy lloje taksash përfaqësuan 85.8% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore. Në të kundërt, pesha dhe kontributi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe i taksave të tjera vijuan tkurrjen edhe përgjatë vitit 2019. Gjithashtu, seria e të dhënave për taksat vendore përjashtuar bashkinë Tiranë tregon për një prirje rritëse të moderuar të të ardhurave nga taksat vendore për 60 bashkitë përgjatë periudhës 2010-2019.

Grafik 9. Të ardhurat nga taksat vendore sipas zërave kryesorë



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe transaksionet e kryera mbi to, përbën një burim të qenësishëm dhe të qëndrueshëm të ardhurash për buxhetin vendor. Në tre vitet e fundit, të ardhurat nga kjo taksë vlerësohen në rreth 0.3% ndaj PBB-së nominale, raport ky ndjeshëm më ulët krahasuar me mesataren e BE-së prej rreth 1.6% të PBB-së për vitin 2017 (NALAS 2019). Ndonëse ndër vite të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme kanë ndjekur përgjithësisht prirje rritëse, problematikat e lidhura me të drejtat e pronësisë dhe mungesës së regjistrave kadastralë, ndër të tjera, pengojnë shfrytëzimin e plotë të potencialit të kësaj takse. Në vijim të reformimit rrënjësor të kësaj takse nëpërmjet Ligjit nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, 'Për sistemin e taksave vendore', të ndryshuar", viti 2019 pritej të ishte dhe viti kur të gjitha bashkitë në vend do të aplikonin taksën e pronës sipas metodologjisë të re, bazuar në komunikimet në media të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Aktualisht, jo të gjitha bashkitë e kanë ndërmarrë këtë hap, si pasojë e problematikave në mbledhjen e të dhënave të nevojshme për aplikimin e kësaj metodologjie.

Të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme regjistruan një vlerë prej rreth 5.2 miliard lekë8 duke shënuar një rënie të lehtë krahasuar me vitin e mëparshëm. Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore, mbi truallin dhe mbi transferimin e të drejtave të pronësisë shënuan rënie duke kontribuar negativisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga taksa e pronës. Në të kundërt, të ardhurat nga taksa e ndërtesës shënuan rritje vjetore me rreth 3.4% në terma vjetorë, por pa arritur të kundërbilancojnë efektin negativ të kategorive të tjera. Në rreth 47.5% të bashkive (29/61 bashki), të ardhurat nga taksat e pronës rezultojnë në rënie.

Grafik 10. Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, rreth 43.5% e të ardhurave nga taksa për pasuritë e paluajtshme mblidhet në bashkinë Tiranë, rezultat i përqendrimit të një numri të lartë banesash dhe ndërtesash në këtë territor. Bashkia Durrës renditet e dyta për nga pesha në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme me rreth 6.4% ndaj totalit për periudhën e konsideruar.

Grafik 11. Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme (sipas bashkive)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në terma strukturorë, të ardhurat nga taksat mbi ndërtesat zënë peshën më të madhe në totalin nga të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme (mesatarisht 75% në tre vitet e fundit). Për vitin 2019, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një nivel prej rreth 3.9 miliard lekë, në rritje me rreth 3.4% në terma vjetorë. Rreth 46.8% e të ardhurave totale nga taksa e ndërtesës u mblodh në bashkinë Tiranë ndjekur nga bashkitë Durrës (6.4% ndaj totalit) dhe Vlorë (4.6% ndaj totalit). Megjithatë, niveli aktual i të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë tregon se rezultatet e reformës dhe metodologjisë së re, ende nuk janë materializuar. Në mungesë të informacioneve të detajuara, ecuria aktuale e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat mund të interpretohet në disa mënyra: (i) metodologjia e re e cila solli një rritje të barrës fiskale mund të ketë krijuar pamundësi për pagesën e kësaj takse nga taksapaguesit dhe të ketë rritur nivelin e mos-pagesës të saj; (ii) metodologjia e re mund të ketë ulur - rritur barrën fiskale nga një kategori taksapaguesish tek tjetra, me rezultante kompensuese të njëra – tjetrës, pra me efekt të papërfillshëm në total; (iii) me aplikimin e metodologjisë së re, nuk është arritur të rritet baza e taksueshme sidomos në ato bashki që po përdoret UK si agjent tatimor (dhe mund të ketë ende lidhje të paligjshme/të paregjistruara) apo jo e gjithë popullata është e mbuluar me shërbim; (iv) ndodhitë që karakterizuan gjysmën e dytë të vitit 2019 (zgjedhjet vendore, tërmetet e njëpasnjëshme) mund të kenë ndikuar negativisht në kryerjen e pagesave për këtë taksë. Në lidhje me këtë të fundit, të dhënat për vitin 2019, nuk tregojnë për rënie të theksuar të nivelit të arkëtimit veçanërisht në bashkitë me dëme të mëdha nga tërmeti i 27 Nëntorit 2019: bashkia Durrës (-9.9%); Tiranë (+1%); Krujë (-5%), Lezhë (-2.2%) etj.

Grafik 12. Të ardhura nga taksat mbi ndërtesën dhe tokën bujqësore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga *taksa mbi tokën bujqësore*, ndonëse me peshë të moderuar, kontribuan me rreth 517.4 milionë lekë (në rënie me rreth 17.7% në terma vjetorë) në kategorinë e të ardhurave nga taksa mbi pronën. Në ndryshim nga elementi i përqendrimit të të ardhurave nga taksa e ndërtesës në një numër të kufizuar bashkish, të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore rezultojnë të jenë të shpërndara ndërmjet bashkive. Niveli më i lartë i kësaj takse u mblodh në bashkinë Fier (rreth 12.6% e totalit), ndjekur nga bashkitë Lushnje (8.5%), Divjakë (4.7%), dhe Roskovec (4.0%), lidhur dhe me karakterin bujqësor të ekonomive të këtyre bashkive. Të ardhurat *nga taksa e truallit* zënë një peshë të ulët në totalin e të ardhurave nga taksat e pronës (rreth 2.9%) dhe shënuan rënie me rreth 5.5% në terma vjetorë. Në të njëjtin drejtim ndikuan dhe të ardhurat nga *taksa mbi transferimin e të drejtave të pronësisë*, të cilat shënuan rënie me rreth 2.0% në terma vjetorë.

Elementi i dytë i rëndësishëm në të ardhurat nga taksat vendore përfaqësohet nga të hyrat nga *taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*. Të hyrat nga kjo taksë vijojnë të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm dhe qenësishëm në buxhetin vendor: në vitin 2019 të ardhurat nga kjo taksë përfaqësuan rreth 52.9% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore dhe rreth 33% ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Këta dy tregues sinjalizojnë për varësi të lartë të buxhetit vendor nga kjo taksë dhe rreziqe të shtuara varësisht natyrës ciklike të saj. Gjithashtu, mund të ndodhë që në prani të kufizimeve financiare, bashkitë të zhvendosin preferencat për likuiditet në terma afatshkurtër, në kurriz të zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë.

Grafik 13. Ecuria e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja vijuan të rriten me ritme të përshpejtuara për të tretin vit radhazi, veçanërisht në bashkinë Tiranë. Në vitin 2019, të ardhurat nga kjo taksë shënuan një nivel prej rreth 8.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 16.9% në terma vjetorë, ose rreth 1.2 miliardë lekë më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm. Përjashtuar të ardhurat e arkëtuara nga bashkia Tiranë, 60 bashkitë e tjera në vend mblodhën rreth 2.1 miliardë lekë nga TNI, me rritje në terma vjetorë me rreth 25.8%. Performanca në të ardhurat prej kësaj takse sugjeron për vijimësi të presioneve zhvillimore (rritje e numrit të lejeve të ndërtimit nga bashkitë në vijim të miratimit të planeve të përgjithshme vendore konkretisht, rreth 1,194 leje të reja në vitin 2018 në rreth 848 leje të reja në nëntë muajt e parë të vitit 2019),[9] ndonëse ky presion është përqendruar kryesisht në bashkinë Tiranë. Zbatimi i Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) nëpërmjet lejeve të reja të ndërtimit, nga një anë, ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga TNI për bashkitë, nga ana tjetër, i vendos ato në një pozicion sfidues për ofrimin e infrastrukturave të nevojshme publike, të cilat gjithashtu kërkojnë financime si në zhvillim fillestar ashtu dhe në mirëmbajtje të vazhdueshme.[10]

Në nivel mesatar, të ardhurat nga TNI (nga ndërtimet e reja dhe të ardhurat nga legalizimet) përfaqësuan rreth 52.9% të të ardhurave nga taksat vendore në vitin 2019, në rritje me rreth 3 pikë përqindjeje krahasuar me vlerën e këtij raporti në vitin e mëparshëm. Për rreth 18% të bashkive ose 11/61 bashki, të ardhurat nga kjo taksë qëndrojnë mbi mesataren kombëtare të raportit TNI/të ardhura nga taksat vendore. Ndërkohë, në rreth 13.1% të bashkive ose 8/61 bashki të ardhurat nga kjo taksë përfaqësojnë më pak se 10% të të ardhurave nga taksat vendore duke reflektuar deri diku edhe presione më të ulëta zhvillimi apo mungesë kërkese për zhvillime të reja.

Grafik 14. TNI, bashkitë ndaj mesatares kombëtare për vitin 2019



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndonëse me peshë të madhe në të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga TNI nuk realizohen njëtrajtësisht në të gjitha bashkitë. Rreth 73.8% e të ardhurave nga kjo taksë u mblodh në bashkinë Tiranë dhe diferenca në 60 bashkitë e tjera në vend. Në vitin 2019, bashkia Tiranë arkëtoi rreth 6.2 miliardë lekë, në rritje me rreth 14% në terma vjetorë. Rritja me ritme dy-shifrore e të ardhurave nga kjo taksë, është në linjë me të dhënat mbi numrin e lejeve të ndërtimit (në vitin 2018 bashkia Tiranë rezulton të ketë dhënë rreth 179 dhe në nëntë muajt e parë të vitit 2019 kjo bashki rezulton të ketë dhënë rreth 225 leje, rreth 46 leje më shumë)[11]. Praktikisht, bazuar në informacionin nga lejet e ndërtimit, në nëntë muajt e parë të vitit 2019, në bashkinë Tiranë do të shtohen 1.2 milionë metër katrorë sipërfaqe ndërtimore, rreth 57.8% më shumë krahasuar me totalin e sipërfaqes sipas lejeve të ndërtimit për vitin 2018. Këto të dhëna, konfirmojnë sërish për karakterin specifik të kësaj bashkie dhe diferencën e madhe që është krijuar midis bashkisë Tiranë dhe 60 bashkive të tjera në vend. Me diferencë shumë të madhe nga bashkia Tiranë, bashkia Lezhë mblodhi rreth 4.7% të të ardhurave nga TNI, ndjekura nga bashkitë Durrës (3%), Kamëz (2.3%), Vorë (2.1%) dhe Kavajë (2%). Në bashkinë Lezhë, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja rezulton të jenë rreth 394.2 milionë lekë nga rreth 143.5 milionë lekë që ishin në vitin e mëparshëm (në nëntë muajt e parë të vitit 2019, bashkia Lezhë regjistron 30 leje të dhëna, vlerësuar në rreth 63.2 mijë metër katror ndërtim). E njëjta pirje vihet re edhe në bashkinë Durrës ku nga rreth 234 milionë lekë në vitin 2018, në vitin 2019 u mblodhën rreth 257.2 milionë lekë. Në të kundërt, bashkitë Memaliaj dhe Kuçovë[12] rezultojnë të mos kenë gjeneruar të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2019.

Grafik 15. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total = 100%)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Taksa e ndikimit në infrastrukturë është shndërruar në një burim të qenësishëm i të ardhurave në buxhetin vendor, veçanërisht në bashkitë e mëdha si Tirana, Durrësi, Lezha etj. Rritja e kontributit të kësaj takse në buxhetin vendor do të kërkonte njëkohësisht parashikime dhe angazhime afatmesme deri/dhe afatgjata në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike vendore për zhvillimet e reja. Në total, në nëntë muajt e parë e të vitit 2019 janë shtuar rreth 1.6 milionë metër katror ndërtime të reja të cilat do të duhej të shoqëroheshin me infrastruktura publike mbështetëse. Gjithashtu, duke qenë një burim të ardhurash i fundëm dhe jo i vazhdueshëm, bashkitë duhet të gjejnë zgjidhje dhe të aftësohen për t'u bërë ballë detyrimeve financiare të sotme dhe atyre të ardhshme, përballë një buxheti të kufizuar – kjo do të krijonte kushte të favorshme dhe do të ishte në përputhje me konceptin e barazisë ndër-gjeneracionale. Praktikisht, të ardhurat e realizuara sot nga kjo taksë do të duhej të investoheshin për të siguruar infrastrukturat e nevojshme publike si dhe operimin e tyre në të ardhmen, pa rënduar në buxhetet e gjeneratave të ardhshme.

Të ardhurat nga *tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël,* dikur një burim financiar i rëndësishëm në buxhetet vendore (në vitin 2015, të ardhurat nga kjo taksë përfaqësonin rreth 24.7% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore, ndërsa, në vitin 2019 ato përfaqësuan rreth 2.4% të tyre), vijojnë të tkurrin kontributin e tyre në mënyrë progresive.

Grafik 16. Ecuria e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Me ndryshimet legjislative[13] të ndërmarra në vitin 2016, qeverisja vendore humbi një prej instrumenteve për të tërhequr dhe nxitur krijimin e ndërmarrjeve të reja në territoret në administrim. Në terma nominalë, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një vlerë prej 376.3 milionë lekë në 2019, me një rritje prej 14.2% krahasuar me vitin 2018. Në terma afatgjatë, të ardhurat nga kjo taksë pritet të ulin në mënyrë progresive kontributin e tyre në totalin e të ardhurave nga burime të veta vendore.

Ndonëse në masë më të ulët, të ardhurat nga *taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier* kontribuoi pozitivisht në rritjen e përgjithshme të të ardhurave nga taksat vendore. Për vitin 2019, të ardhurat nga kjo taksë shënuan një nivel prej rreth 250 milionë lekë, në rritje me rreth 16.8% në terma vjetorë.

Grafik 17. Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Për vitin 2019, rreth 45.9% e të ardhurave nga taksa e hotelit u mblodhën në bashkinë Tiranë, ndjekur nga bashkia Sarandë me rreth 9.6% të të ardhurave totale. Ndërkohë, niveli i të ardhurave të mbledhura nga bashkitë e tjera me potencial turistik rezulton të jetë relativisht i ulët, ndikuar nga sezonaliteti që karakterizon sezonin turistik në vend si dhe mund të sinjalizojë për probleme strukturore në lidhje me regjistrimin e strukturave akomoduese dhe raportimin e numrit të pushuesve.

2.1.2 | TË ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Tarifat vendore paguhen në shkëmbim të të mirave, shërbimeve apo të drejtave të përftuara. Ato përfaqësojnë një kategori të hyrash në buxhetet vendore mbi të cilat bashkitë kanë autoritet të plotë në përcaktimin e nivelit dhe elementëve të tjerë përbërës si dhe mënyrës së përdorimit të tyre. Të ardhurat nga tarifat vendore përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të hyrash në buxhetin e bashkive duke përfaqësuar rreth 36.5% ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Në përgjithësi, të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin prirje rritëse nga viti në vit, diktuar deri diku edhe nga performanca e një grupi bashkish të cilat kanë aplikuar rritje të nivelit të tarifave vendore si dhe përdorimi i UK-ve si agjentë tatimorë.

Për një periudhë pesë-vjeçare, të ardhurat nga tarifat vendore kanë shënuar norma rritjeje dy-shifrore. Në të kundërt, në vitin 2019 të ardhurat nga tarifat regjistruan një nivel prej rreth 9.3 miliardë lekë, në rënie me rreth 2.4% krahasuar me vitin e mëparshëm. Ndër faktorët që mund të kenë kontribuar negativisht në ecurinë e të ardhurave nga tarifat vendore, vlerësohet të jenë tërmetet e 22 Shtatorit dhe 26 Nëntorit të cilët prekën një numër të konsiderueshëm bashkish.

Grafik 18. Performanca e zërave kryesorë të tarifave vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndër elementët e të ardhurave nga tarifat vendore, të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike (menaxhimi i mbetjeve, ndriçimi dhe gjelbërimi, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, ujitja dhe kullimi) regjistruan një vlerë prej rreth 4.3 miliardë lekë, një rënie me rreth 4.4% në terma vjetorë. Rreth 88.1% e të ardhurave nga tarifat për shërbimet publike u mblodhën nga tarifa e pastrimit dhe higjienës (ku rreth 50% e tyre mblidhet në bashkinë Tiranë). Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik

regjistruan një nivel prej rreth 282.5 milionë lekë duke përfaqësuar rreth 6.5% ndaj totalit nga tarifat e shërbimeve publike.

Tabelë 1. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në lekë)

	Në vlerë	Pesha ndaj totalit
Tarifë pastrimi dhe higjene	3,807,798,998	88.1%
Tarifa për ndriçimin publik	282,553,047	6.5%
Tarifa për gjelbërimin	224,297,566	5.2%
Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet	58,442	0.001%
Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	6,668,726	0.2%
Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	4,321,376,779	100.0%

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit regjistruan shifra relativisht modeste dhe janë grumbulluar nga bashkitë Elbasan, Lezhë, Roskovec, Divjakë dhe Lushnjë. Paraprakisht, mund të thuhet se ka marzhe përmirësimi të mbledhjes së kësaj tarife, sidomos në ato bashki ku toka bujqësore nën juridiksion ka nevojë për shërbime të ujitjes dhe kullimit.

Tarifa për *zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave* gjithashtu ka pësuar një rritje në periudhën në analizë duke shënuar një vlerë prej 1.4 miliardë lekë në 2019, nga 1.3 miliardë lekë të mbledhura në 2018. Nëse do të shikonim performancën e zërave specifikë, rezulton se të ardhurat nga *tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi (bare dhe restorante)* zënë peshën më të lartë me rreth 52.0% të totalit, ndjekur nga të ardhurat nga *tarifa për parkingjet* me rreth 40.8% të totalit. Lidhur me të ardhurat nga tarifa për parkingjet, vlen për t'u përmendur fakti se vetëm bashkia Tiranë mbledh rreth 83.5% të të ardhurave totale nga kjo tarifë. Në këtë drejtim, bashkitë e tjera të mëdha, qendra qarku, nuk kanë patur të njëjtën performancë, ndonëse kanë potencial (duke konsideruar numrin e popullsisë dhe të automjeteve).

2.1.3 | HUAMARRJA VENDORE DHE DETYRIMET E PRAPAMBETURA

Bazuar në legjislacionin në fuqi, në mungesë apo prani të mjeteve financiare të pamjaftueshme, bashkitë mund të marrin hua afatshkurtër me qëllim mbulimin e nevojave për likuiditet afatshkurtër ose afatgjatë me qëllim financimin e shpenzimeve kapitale apo ri-financimin e një huaje ekzistuese. Termat dhe kushtet për të aksesuar hua nga qeverisja vendore në Shqipëri janë specifikisht të rregulluara në Ligjin nr. 9869/2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore". Bazuar në të dhënat e publikuara në regjistrin e borxhit në fund të vitit 2019,[14] rezulton se bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë, Elbasan, Lezhë dhe ish-komuna Petrelë kanë përfituar hua nga sistemi bankar vendas. Të gjitha huatë e lartpërmendura janë kontraktuar në vitin 2010 dhe vitin 2014, me qëllim financimin e projekteve infrastrukturore. Pas vitit 2014, asnjë bashki nuk rezulton të ketë marrë hua.

Tabelë 1. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në lekë)

Huamarësi	Huadhënësi	Shuma (në milionë lekë)	Nënshkrar më:	Përfudon më:	Stoku në fund të vitit 2019:
Bashkia Korçë	Pro Credit	100	2010	2020	16.27
Bashkia Korçë	ISBA	200	2014	2024	121.43
Bashkia Pogradec	Pro Credit	113	2010	2020	5.74
Bashkia Vlorë	BKT	420	2010	2020	35.25
Kom. Petrelë	BKT	15	2010	2019	0.00
Bashkia Elbasan	BKT	800	2010	2020	364.22
Bashkia Lezhë	ISBA	107	2014	2023	38.80

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Regjistri i Borxhit 2019T4)[15]

Në total, stoku i borxhit të qeverisjes vendore në fund të vitit 2019 rezulton të jetë rreth 582 milionë lekë ose rreth 0.034% ndaj PBB-së[16] dhe jep një kontribut marzhinal në shifrën e borxhit publik të përgjithshëm. Krahasuar me të dhënat e vitit 2018, rezulton se bashkitë kanë ulur ekspozimin e tyre ndaj bankave me rreth 134 milionë lekë si dhe detyrimi i ish-komunës Petrelë është shlyer tërësisht.

Pas vitit 2014, asnjë nga bashkitë nuk rezulton të ketë marrë hua të reja, pavarësisht nevojave të theksuara për investime, të cilat në bashkitë e mëdha duket të jenë adresuar nëpërmjet përdorimit të skemave të PPP-ve. Trajektorja e konsolidimit fiskal të ndërmarrë nga MFE, duket të ketë kufizuar hapësirën për huamarrje të re për bashkitë, për sa kohë borxhi vendor rrit nivelin e përgjithshëm të borxhit publik.

Grafik 19. Borxhi publik përkundrejt kriterit të Mastriktit



Burimi: INSTAT, Ministria a Financave dhe Ekonomisë dhe përpunime të autorëve

Ndërkohë, krahas treguesve të borxhit, bashkitë në vend mbartin ndër vite stokun e detyrimeve të prapambetura, të cilat në fund të vitit 2019 u vlerësuan në rreth 8.2 miliardë lekë, 14 herë më i lartë se stoku i borxhit të qeverisjes vendore. Në raport ndaj PBB-së, detyrimet e prapambetura përfaqësuan rreth 0.48% nga një nivel prej rreth 0.41% një vit më parë. Mesatarisht, detyrimet e prapambetura të bashkive rëndojnë qytetarët për rreth 2,918 lekë në fund të vitit 2019, nga rreth 2,418 lekë për frymë në fund të vitit 2018.[17] Në nivel bashkie, detyrimet e prapambetura për frymë shënojnë vlerën maksimale në bashkinë Kavajë me rreth 19,111 lekë për frymë dhe vlerën minimale në bashkinë Patos e cila rezulton të mos ketë detyrime të prapambetura.

Hapësirë informuese 3

Detyrimet e prapambetura: sa rëndojnë në buxhetet e bashkive?

Detyrimet e prapambetura të bashkive u evidentuan në mënyrë sistematike duke filluar prej vitit 2015 në vijim të miratimit të VKM nr. 50/2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit" dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në fund të vitit 2015, stoku i detyrimeve të prapambetura ishte rreth 12.1 miliardë lekë, vlerë kjo shqetësuese si në nivel vendor ashtu dhe në nivel qendror. Shlyerja u këtyre detyrimeve, pjesërisht të krijuara nga ish-komunat që iu bashkëngjitën bashkive të reja në vijim të reformës administrative dhe territoriale përbën barrë të qenësishme për buxhetet vendore.

Grafik 20. Stoku i detyrimeve të prapambetura (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në këtë kuadër, qeveria qendrore merr përsipër vetëm "shlyerjen e detyrimeve për punimet e kryera, por të papaguara në kuadër të financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njësive të qeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njësive të qeverisjes vendore." Duke filluar prej vitit 2015, stoku i detyrimeve të prapambetura u tkurr në mënyrë progresive, duke regjistruar një nivel prej rreth 6.8 miliard lekë në fund të vitit 2018. Në të kundërt, stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2018 shënoi një nivel prej rreth 8.2 miliardë

lekë. Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2018, stoku aktual rezulton të jetë zgjeruar me rreth 1.4 miliardë lekë, ose me rreth 20.7%. Zgjerimi i detyrimeve të prapambetura dhe që do të duhet të shlyen në periudhën afatmesme, rezulton të ketë ndodhur në 66% të bashkive (ose 40/61 bashki) dhe veçanërisht në bashkitë: Kavajë, Kukës, Berat, Roskovec, Kamëz etj. Në të kundërt, rreth 34.4% e bashkive (ose rreth 21 bashki) rezultojnë të kenë kontribuar në kahun ulës të stokut të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2019 krahasuar me nivelin e tij në fund të vitit 2019. Rënie e qenësishme e detyrimeve të prapambetura vihet re në bashkitë Tiranë, Vlorë dhe Durrës.

Grafik 21. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas bashkive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, rreth 55.4% e stokut të detyrimeve të prapambetura mbartet nga 8 bashki. Niveli më i lartë i stokut të detyrimeve të prapambetura u regjistrua në bashkinë Tiranë me rreth 1.7 miliardë lekë, ose 21.5% ndaj stokut total në fund të vitit 2019. Krahasuar me një vit më parë, stoku i detyrimeve të prapambetura i bashkisë Tiranë, rezulton të jetë tkurrur me rreth 12.0% në fund të vitit 2019. Bashkia Kavajë renditet e dyta për nga niveli i detyrimeve të prapambetura, me rreth 766.2 milionë lekë, ose rreth 9.4% ndaj totalit. Gjatë vitit 2019, bashkia Kavajë regjistron zgjerim të stokut të detyrimeve të prapambetura me rreth 377.3 milionë lekë ose rritje vjetore me rreth 97%. Gjithashtu, në rritje rezulton edhe stoku i detyrimeve të prapambetura në bashkitë Kamëz, Kukës, Roskovec etj.

2.2 | TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA

Me miratimin e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", u rishikuan dhe shtuan kategoritë e taksave të ndara ndërmjet qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Kështu, bashkitë përftojnë: (i) 97% e të ardhurave nga taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, persona fizikë dhe juridikë;[18] (ii) 25% të të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura; (iii) 5% të të ardhurave nga renta minerare; dhe (iv) 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale nuk rezultojnë të jenë shpërndarë për bashkitë gjatë vitit 2019. Me një llogari të thjeshtë, kjo materializohet në një mungesë të ardhurash për buxhetet vendore prej rreth 922.5 milionë lekë,[19] të cilat do të duhet të ndaheshin ndërmjet bashkive sipas origjinës së tyre bazuar në parashikimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Grafik 22. Të ardhura nga taksat e ndara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ecuria në kohë e të ardhurave nga taksat e ndara ka qenë e luhatshme dhe pesha e këtij zëri ndaj të ardhurave nga burimet e veta shënoi një nivel prej rreth 6.6% në vitin 2019. Në tërësi, të ardhurat nga taksat e ndara kontribuan në buxhetin vendor me rreth 1.7 miliardë lekë në fund të vitit 2019, në rritje me rreth 15.2% në terma vjetorë.

2.3 | TË ARDHURAT NGA TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME DHE SEKTORIALE

Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqeverisjes vendore si dhe pajisja me shërbime publike vendore me eficiencë dhe efikasitet përbëjnë elementë thelbësorë për të ndikuar dhe nxitur zhvillimin ekonomik në territorin në administrim. Në këtë drejtim, të hyrat nga transferta e pakushtëzuar përfaqësojnë një burim thelbësor në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të bashkive të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", duke synuar mbylljen e hendekut negativ midis nevojës për shpenzime dhe kapacitetit fiskal (kapacitetit për të gjeneruar të ardhura. Krahas tyre, kushtet e fatkeqësive natyrore të ndodhura përgjatë vitit 2019 dhe pandemisë COVID-19 së fillim vitit 2020 rëndësia dhe qëndrueshmëria e këtij burimi financiar paraqet rëndësi të veçantë për bashkitë. Bazuar në informacionin e publikuar nga MoFE dhe udhëzimet përkatëse për hartimin e PBA-së 2021-2023, transferta e pakushtëzuar parashikohet në rritje deri në vitin 2023 (kryesisht transferta e pakushtëzuar e përgjithshme). Në kushtet kur viti 2019 u mbyll me një bilanc dëmesh të qenësishëm, gjashtëmujori i parë nën efektin e pandemisë COVID-19, vlerësimet ndërkombëtare për rritjen ekonomike janë në kahun pesimist, mbetet për tu vlerësuar nëse niveli i paraqitur i transfertës së pakushtëzuar do të jetë e mundur të realizohet.

Në vijim të transferimit simetrik në titull ekskluziv të një sërë funksionesh në vitin 2016, ushtrimi i tyre u realizua nëpërmjet mjeteve monetare të transferuara nga qeveria qendrore drejt asaj vendore, nëpërmjet transfertës specifike. Në përmbyllje të fazës tranzitore të transferimit të këtyre funksioneve apo duke filluar nga fillim viti 2019, ato financohen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale, fondet e të cilës do të përdoren në autonomi.[20] Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" sanksionoi përmasën dhe mënyrën e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar: për çdo vit buxhetor, ajo është jo më pak se 1% e PBB-së sipas parashikimeve dhe vlerësimeve makroekonomike të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe, në çdo rast, nuk mund të jetë më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm; ndarja e saj bëhet nëpërmjet formulës së miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në vitin 2019, bashkitë përftuan rreth 24.7 miliardë lekë në total në trajtën e transfertës së pakushtëzuar (së bashku me transfertën sektoriale), në rritje me rreth 4.6% krahasuar me vitin e mëparshëm. Norma e rritjes së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale duket të jetë moderuar në mënyrë progresive nga viti 2016 në vitin 2019, si pasojë e shuarjes së efektit bazë të rritjes nga transferta (specifike) sektoriale. Në buxhetet vendore, rreth 15.9 miliardë lekë u shpërndanë në trajtën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe rreth 9.0 miliardë lekë në trajtën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale (për funksionet e reja të transferuara në vitin 2016). [21]

Grafik 23. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar ndër vite



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al *Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Transferta e pakushtëzuar dhe specifike përbën burimin financiar kryesor për bashkitë duke përfaqësuar mesatarisht 47.5% të burimeve financiare të disponueshme. Rëndësia e këtij burimi bëhet më e dukshme në nivel bashkie, ku në rreth 85.2% të bashkive (ose 52 prej tyre) pesha e të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike rezulton mbi mesataren kombëtare për vitin 2019. Në bashkinë Pustec, 92.7% e të ardhurave vendore përfaqësohet nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike. Në të kundërt, pesha minimale ndaj burimeve financiare të disponueshme u regjistrua në bashkinë Tiranë, me rreth 19.7%.

Grafik 24. Varësia nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike, viti 2019



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.4 | TË ARDHURAT NGA TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA

Bazuar në nenin 27, të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", transfertat e kushtëzuara jepen për ushtrimin e funksioneve të deleguara dhe për projekte të veçanta (të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar) ku kërkohet bashkëpunimi i njësive vendore. Nisur nga sa specifikuar në ligj, fondet e kushtëzuara të transferuara në bashki përfshijnë jo vetëm fondet për ushtrimin e funksione të deleguara, por në to mund të kanalizohen edhe fondet për investime (përfshirë këtu dhe FZHR). Ndonëse nuk ushtrojnë kontroll mbi destinacionin e tyre, të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara përfaqësojnë rreth *36.3% ndaj totalit të burimeve financiare të bashkive* në vitin 2019. Pesha e këtyre transfertave ndaj totalit të burimeve financiare është tkurrur gjatë periudhës së konsideruar, nga një nivel mesatar prej rreth 50% në periudhën 2010-2014 në nivelin mesatar prej 39.9% në tre vitet e fundit. Gjatë vitit 2019, qeverisja qendrore u transferoi bashkive rreth 29.6 miliardë lekë në trajtën e transfertës së kushtëzuar, rreth 12.6% më pak krahasuar me një vit më parë.

Grafik 25. Të ardhura nga transfertat e kushtëzuara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Gjatë vitit 2019, fondet e transferuara nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale[22] shënuan një nivel prej rreth 20.6 miliardë lekë, në rënie të lehtë me rreth 2.3% krahasuar me vitin e mëparshëm. Këto fonde u transferohen bashkive në trajtën e transfertës së kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë, dhe më tej bashkitë bëjnë shpërndarjen e tyre në përfituesit fundorë. Gjatë këtij viti, evidentohet një rritje e lehtë e fondeve të kanalizuara në nivel vendor nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën e cila transferoi

rreth 2.8 miliardë lekë, në rritje me rreth 0.5% në terma vjetorë. Entitetet qendrore përgjegjëse për zhvillimin urban transferuan rreth 1.5 miliardë lekë në nivel bashkie (-76.5% krahasuar me vitin e mëparshëm), të cilat janë shpenzuar më së shumti në përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe zhvillimit të komunitetit (FZHR). Ministria përgjegjëse për arsimin, sportin dhe rininë shpenzoi në nivel vendor rreth 2.7 miliardë lekë në vitin 2019, nga të cilat rreth 2.5 miliardë lekë vlerësohet të jenë shpenzuar në investime për përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

2.5 | BURIMET FINANCIARE: SA PARA PATËN NË DISPOZICION BASHKITË NË VITIN 2019?

Ky seksion synon të pasqyrojë nga burojnë fondet me të cilat bashkitë ushtrojnë funksionet dhe përgjegjësitë, ofrojnë shërbime për komunitetin përkatës dhe performancën e tyre në fund të vitit 2019.[23] Burimet financiare totale të qeverisjes vendore regjistruan një vlerë prej 81.5 miliardë lekë në fund të vitit 2019, në rënie me rreth 2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.[24] Nëse nga totali i burimeve financiare do të përjashtonim ato kategori të konsideruara me destinacion (transferta të kushtëzuara), të ardhurat mbi të cilat bashkitë ushtrojnë autoritet dhe kanë të drejta vendimmarrjeje shënuan një vlerë prej rreth 51.9 miliardë lekë, në rritje me rreth 5.4% në terma vjetorë.

Grafik 26. Ecuria e burimeve financiare totale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Burimet financiare mbi të cilat bashkitë kanë liri relative përdorimi në fund të vitit 2019 përfaqësuan rreth 63.7% të burimeve financiare totale dhe përfshijnë: të ardhurat nga burimet e veta (31.4%), të ardhura nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale[25] (30.3%) dhe të ardhurat nga taksa të ndara (2.1%). Në të kundërt, burimet financiare të kushtëzuara, përfaqësuan rreth 36.3% ndaj totalit, rreth 10.1 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (llogaritur si mesatare e peshës së kësaj kategorie ndaj totalit për periudhat e referuara).

Tabelë 3. Burime financiare sipas kategorive (në lekë)

	Të ardhura nga burime të veta	Transferta e pa-kushtëzuar dhe specifike	Taksa të ndara	Transferta të kushtëzuara	Të trashëguara	Burime financiare totale(pa fondet e trashëguara)
2010	12.9	10.6	1.2	25.8	5.2	50.4
2011	12.6	10.2	1.3	23.4	3.6	47.6
2012	12.0	9.2	1.4	22.7	3.8	45.4
2013	12.2	11.0	1.5	25.2	4.2	49.8
2014	14.4	12.1	1.1	28.6	4.6	56.2
2015	13.1	11.3	1.1	26.4	8.3	51.8
2016	16.8	18.1	1.0	25.6	7.8	61.6
2017	20.3	21.9	1.2	32.3	5.1	75.8
2018	24.2	23.6	1.5	33.9	1.5	83.1
2019	25.6	24.7	1.7	29.6	4.3	81.5

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ecuria e burimeve financiare totale në fund të vitit 2019 u përcaktua prej ecurisë së të hyrave nga burimet e veta vendore, të cilat kontribuan me rreth 1.6 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të burimeve financiare. Në të njëjtin drejtim, edhe pse në masë më të vogël (1.3 pikë përqindje), kontribuan edhe të hyrat nga transferta e pakushtëzuar dhe ajo sektoriale.

Grafik 27. Kontributi i kategorive (në pikë përqindje) në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në përqindje)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Hapësirë informuese 4
Tregues të autonomisë financiare vendore

Struktura e burimeve të financimit për bashkitë mund të përdoret si një tregues i tërthortë për të vlerësuar kapacitetin financiar të tyre, mundësinë për të ndërmarrë investime në mënyrë të pavarur dhe për të përmbushur kërkesat e komunitetit për shërbime publike. Mesatarisht, për 61 bashkitë në vend, të ardhurat nga burimet e veta përfaqësuan rreth 31.4% ndaj burimeve totale, të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe ajo specifike rreth 30.3% dhe të ardhurat nga taksat e ndara rreth 2.2% ndaj burimeve të financimit totale në fund të vitit 2019.

Grafik 28. Burimet financiare sipas bashkive viti 2019



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, pesha që zënë të ardhurat e veta (taksa, tarifa dhe të tjera) në totalin e burimeve të financimit luhatet në një interval të gjerë vlerash: vlera minimale u regjistrua në bashkinë Has me 2.3% dhe vlera maksimale në bashkinë Tiranë me rreth 65%. Në përpjesëtim të zhdrejtë, aty ku të ardhurat nga burimet vendore janë të ulëta, të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike financojnë gjerësisht buxhetin e bashkisë. Historikisht, transfertat e kushtëzuara kanë përfaqësuar nivelin më të lartë të të hyrave në buxhetet vendore, por në fund të vitit 2019 ato shfaqën një rënie krahasuar me vitin 2018 (40.7% e totalit) duke zënë rreth 36.3% të totalit të burimeve financiare. Një panoramë e përgjithshme mbi burimet e financimit të bashkive vijon të evidentojë diferenca të theksuara ndërmjet tyre edhe bazuar në të dhënat me bazë vjetore për 2019.

3. SHPENZIMET VENDORE: SI I PËRDORËN BASHKITË PARATË NË DISPOZICION?



Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën anën tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Rëndësia e qeverisjes vendore në terma të shpenzimeve rezulton të jetë rritur duke filluar prej vitit 2015. Treguesi i shpenzimeve të kryera me fonde të veta ndaj PBB-së shënoi rritje nga rreth 2.3% në 3.3% në fund të vitit 2019.

Grafik 29. Tregues të shpenzimeve vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në përmirësim rezulton gjithashtu edhe treguesi i shpenzimeve me fonde të veta të bashkive ndaj shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë, i cili në vitin 2019 u vlerësua në nivelin 11.4%, në rritje me 1.3 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Deri në vitin 2015 ky raport nuk paraqet ndryshime të ndjeshme, dhe rezulton i stabilizuar në një nivel mesatar prej rreth 7.4%. Me shtimin e funksioneve të bashkive dhe rritjen e nivelit të transfertave ndërqeveritare të pakushtëzuara, ky raport u rrit në nivelin 11.4% në fund të vitit 2019.

Mesatarisht, në Shqipëri qeverisja vendore kanalizon mbi 72.3% të burimeve financiare totale për mbulimin e shpenzimeve korrente dhe rreth 27.7% për shpenzime kapitale. Shpenzimet kapitale të kryera nga qeverisja vendore përfaqësuan rreth 1.5% ndaj PBB-së nominale në vitin 2019, raport ky në rritje me rreth 0.1 pikë përqindjeje krahasuar me nivelin e tij në vitin e mëparshëm. Shpenzimet kapitale të kryera me fonde të veta u vlerësuan në rreth 1.0% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 30. Investimet ndaj PBB-së nominale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve të ushtruara nga qeverisja (vendore apo qendrore) tregon sesi qeverisja vendore dhe ajo qendrore ndajnë mes tyre ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave (matur nga përqindja e shpenzimeve të kryera nga secili nivel i qeverisjes sipas funksioneve bazuar në klasifikimin COFOG). Duke përjashtuar mbrojtjen, si një funksion i ushtruar ekskluzivisht në nivel qendror, në funksionet e tjera pesha e qeverisjes vendore rezulton ndjeshëm më e ulët se ajo e qeverisjes qendrore. Bashkitë ushtrojnë kompetenca më të zgjeruara në *funksionin e strehimit dhe komoditeteve të komunitetit* (rreth 45.7% e shpenzimeve kryhet nga qeverisja vendore) dhe në *funksionin e argëtimit, kulturës dhe çështjeve fetare* (rreth 39.0% e shpenzimeve kryhet nga qeverisja vendore). Gjithashtu, në vitin 2019 rreth 63% e shpenzimeve në *funksionin e mbrojtjes së mjedisit* u krye nga qeverisja vendore.

Grafik 31. Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve (viti 2019)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.1 | SHPENZIMET SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT

Ky seksion ofron një panoramë të përgjithshme mbi mënyrën si janë shpenzuar paratë në dispozicion të bashkive në vitin 2019: sipas burimit të financimit dhe kryqëzuar me kategorizimin sipas natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe sipas funksioneve të qeverisjes (arsim, çështje ekonomike, mbrojtje mjedisi, etj.).

Performanca pozitive në ecurinë e burimeve financiare totale u materializua në zgjerimin e shpenzimeve të kryera nga bashkitë përgjatë vitit 2019. Në fund të vitit 2019, mjetet financiare të kanalizuara nga 61 bashkitë në vend, regjistruan një vlerë prej rreth 85.1 miliardë lekë, shifër kjo rreth 4% më e lartë se ajo e regjistruar në vitin e shkuar.[26] Përjashtuar shpenzimet e kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm, rezulton se bashkitë kanë shpenzuar në vitin 2019 rreth 81.1 miliardë lekë, rreth 0.6% më shumë se një vit më parë. Shpenzimet me fondet e veta të bashkive regjistruan një nivel prej rreth 55.9 miliardë lekë në fund të vitit 2019, duke shënuar një rritje prej 15.7% krahasuar me vitin e mëparshëm. Shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara shënuan një vlerë prej rreth 29.6 miliardë lekë, në ulje me rreth 4.2 miliardë lekë në terma vjetorë apo me rreth 12.6%. Në terma strukturorë, rreth 65.4% e shpenzimeve u krye me fonde të veta, ndërsa 34.6% e tyre me fonde të kushtëzuara.

Grafik 32. Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Mesatarisht në tre vitet e fundit shpenzimet korrente janë mbuluar në masën 59.6% me fonde nga burimet e veta vendore dhe për rreth 40.4% nga burimet financiare të kushtëzuara. Ndërkohë, shpenzimet kapitale u mbuluan mesatarisht në masën 64.7% nga burimet e veta vendore dhe në masën 35.3% nga burimet e kushtëzuara. Në fund të vitit 2019, shpenzimet kapitale u mbuluan në masën 71% nga burimet financiare vendore dhe për rreth 29% nga ato të kushtëzuara (përfshirë këtu fondet nga FZHR).

Grafik 33. Mbulimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale sipas burimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Kryqëzimi i të dhënave sipas burimit të financimit dhe klasifikimit funksional tregon se, funksioni i mbrojtjes sociale mbulohet gjerësisht me fonde të kushtëzuara (transferta e kushtëzuar nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale). Në periudhën e konsideruar, rreth 90.7% e mbrojtjes sociale u financua me transferta të kushtëzuara (transferta në buxhetet familjare për pagesë papunësie dhe PAK). Në të kundërt, bashkitë mbulojnë me fonde të veta rreth 94.4% të shpenzimeve në funksionin e *çështjeve ekonomike*. Në fushën e *strehimit dhe komoditeteve të komunitetit,* rreth 71.7% e shpenzimeve u financua me fonde të veta të bashkive. *Rendi dhe siguria publike, mbrojtja e mjedisit dhe argëtimi, kultura dhe çështjet fetare* janë funksione kostot e të cilave mbulohen gjerësisht nga fondet e veta të bashkive (ndonëse në vlera nominale të ulëta).

Grafik 34. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional dhe burimit të financimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.2 | SHPENZIMET E KRYERA ME FONDE TË VETA TË BASHKIVE

Shpenzimet e kryera me fonde të veta të bashkive regjistruan një nivel prej rreth 55.9 miliardë lekë në vitin 2019, në rritje me rreth 15.7% krahasuar me vitin e mëparshëm.[27] Ndër to, rreth 4.3 miliardë lekë janë shpenzime të kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm. Në vijim, informacionet në lidhje me shpenzimet e kryera me fonde të veta do të analizohen sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të tyre.

Grafik 35. Ecuria e shpenzimeve me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.2.1 | SHPENZIMET ME FONDE TË VETA SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Bazuar në klasifikimin sipas natyrës ekonomike bashkitë përdorën rreth 68.5% të fondeve të tyre për mbulimin e shpenzimeve korrente (rreth 38.2 miliardë lekë) dhe rreth 31.5% në mbulimin e shpenzimeve kapitale (rreth 17.6 miliardë lekë). Kahu i zhvillimeve në shpenzimet e me fonde të veta përgjatë tre viteve të fundit është përcaktuar gjerësisht nga ecuria e shpenzimeve korrente. Në ndryshim me prirjen e tre viteve të fundit, përgjatë vitit 2019, kahu i zhvillimeve në shpenzimet me fonde të veta u përcaktua nga shpenzimet kapitale.

Ndër kategoritë e shpenzimeve korrente, shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime) përbënë rreth 21.6 miliardë lekë gjatë periudhës së konsideruar, në rritje me rreth 5.4% krahasuar me vitin 2018. Shpenzimet për personelin vijojnë të ndjekin prirje rritëse vjetore, ndonëse me ritme më të moderuara ndikuar dhe nga shuarja e efektit të rritjes së numrit të punonjësve si pasojë e transferimit të funksioneve të reja.[28] Kështu, në vijim të rritjes me rreth 53.4% në vitin 2016 (në vijim të transferimit të funksioneve të reja), norma e rritjes u moderua në mënyrë progresive në 8.5% në vitin 2018 dhe në rreth 5.4% në vitin në analizë.

Grafik 36. Kontributi sipas kategorive në shpenzimet me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 37. Kontributi sipas kategorive në shpenzimet me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet operative dhe të tjera[29] regjistruan një nivel prej rreth 16.6 miliardë lekë në fund të vitit 2019, me një rritje prej 13.1% krahasuar me një vit më parë. Në nivel të detajuar, *shpenzimet operative* të kryera me fonde të veta për këtë periudhë shënuan një vlerë prej rreth 14.8 miliardë lekësh, në rritje me rreth 11.2% në terma vjetorë. Thuajse të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative rezultojnë të jenë zgjeruar gjatë vitit 2019: shpenzimet për materiale zyre (+23%); shërbime nga të tretë (+5.5%); shpenzime transporti (+7.8%); shpenzime të tjera operative (+19.5%); dhe mirëmbajtje e zakonshme (+13.2%). Në të kundërt, shpenzimet për udhëtime shënuan rënie me rreth 15.8% në terma vjetorë. Duke filluar prej vitit 2015, ecuria e shpenzimeve operative qartësisht po ndjek një trajektore rritëse, ku fundi i vitit 2019 shënoi nivelin maksimal të tyre. Ndonëse, rritja e shpenzimeve në këtë kategori rezulton të jetë e shpërndarë në thuajse të gjithë nën-zërat përbërës, ecuria e tyre në terma afatmesëm dhe afatgjatë duhet monitoruar me kujdes pasi mund të krijojë probleme qëndrueshmërie financiare për bashkitë.

Shpenzimet për transferta për buxhetet familjare dhe individët gjithashtu janë një zë i rëndësishëm në totalin e shpenzimeve me fonde të veta të bashkive. Për vitin 2019, kjo kategori shpenzimesh shënoi një vlerë prej rreth 1.4 miliard lekë, në rritje me rreth 35.9% në terma vjetorë.

Grafik 38. Shpenzimet operative sipas zërave



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet kapitale ose investimet, përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxheteve vendore dhe një parakusht për zhvillim ekonomik afatgjatë. Ndër vite, niveli i shpenzimeve kapitale ka qenë i luhatshëm dhe paraqet një korrelacion të mirë me ecurinë e burimeve financiare të veta të bashkisë, veçanërisht me të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Pas rënies së konsiderueshme të vërejtur në vitin 2018 (-26.7% në terma vjetorë), shpenzimet për investime në vitin 2019 shënuan një rritje prej 34.7% kundrejt vitit të kaluar, me një vlerë prej rreth 17.6 miliardë lekë. Në terma të funksioneve të qeverisjes, shpenzimet kapitale për funksionet çështjet ekonomike (ku përfshihet infrastruktura e transportit) dhe strehimi dhe komoditetet e komunitetit (ku përfshihen shpenzimet për strehimin dhe urbanistikë, ujësjellës dhe kanalizime vendore, ndriçimi publik) zënë peshën kryesore të shpenzimeve kapitale në të gjitha periudhat e marra në analizë (52.1% dhe 23.5% respektivisht në vitin 2019). Investimet në funksionin strehimi dhe komoditetet e komunitetit kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me rreth 23% në terma vjetorë.

Grafik 39. Prirja e shpenzimeve kapitale me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Me transferimin e kompetencave të reja në lidhje me arsimin parashkollor dhe atë para-universitar, bashkitë kanë rritur nivelin e investimeve në infrastrukturat arsimore. Përkatësisht, investimet në arsim në vitin 2019 regjistruan një nivel prej rreth 2.4 miliardë lekësh, në rritje me rreth 82.6% në terma vjetorë. Në funksionin mbrojtja sociale u investuan rreth 94.5 milionë lekë në vitin 2019, në rënie me rreth 55.8% në terma vjetorë.

Hapësirë informuese 5
Si shpenzuan 61 bashkitë në vitin 2019?

Struktura e shpenzimeve të kryera nga bashkitë, ndonëse paraqet diferenca të theksuara mes tyre, tregon për një prirje të përgjithshme ku mbizotëron mbulimi i shpenzimeve korrente (personel dhe operative dhe të tjera) ndjekur nga kategoria e shpenzimeve kapitale. Në terma mesatarë për vitin 2019, në strukturën e shpenzimeve me fonde të veta të vitit 2019, shpenzimet për personelin rënduan me rreth 38.7% ndaj totalit, ndjekur nga shpenzimet kapitale me rreth 31.5% dhe ato operative dhe të tjera me rreth 29.7% (bazuar në të dhënat e vitit 2019). Sëbashku shpenzimet e personelit dhe ato operative dhe të tjera, apo shpenzimet korrente, përfaqësuan mesatarisht rreth 68.5% të shpenzimeve totale me fonde të veta. Pesha e shpenzimeve për personelin paraqet luhatshmëri të madhe ndërmjet bashkive ku niveli maksimal shënohet në bashkinë Skrapar me rreth 78% ndaj totalit, ndjekur nga bashkitë Fushë – Arrëz (72.7%), Pukë (72.3%), Poliçan (71.6%) dhe Tepelenë (70.1%). Në të

kundërt, kjo kategori shpenzimesh shënon peshën më të ulët në bashkinë Kamëz me rreth 24.5% ndjekur nga bashkia Tiranë me rreth 25.8%.

Në të kundërt, pesha e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve të kryera me fonde të veta të bashkive shënoi nivelin maksimal prej rreth 60.8% në bashkinë Kamëz, ndjekur nga bashkitë Vau i Dejës (53.5%), Mallakastër (46.3%), Vorë (43.3%) dhe Tiranë (41.3%). Nën ndikimin e kufizimeve buxhetore, kapacitetit fiskal të ulët dhe faktorë të tjerë, në bashkitë si Kukësi, Poliçani, Dibra, Kolonja, Puka dhe Skrapari, përqindja e fondeve të shpenzuara për investime rezulton të jetë nën 10% të fondeve të veta në dispozicion.

Grafik 40. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike për 61 bashki (total = 100%), viti 2019



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.2.2 | SHPENZIMET ME FONDE TË VETA SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL

Në klasifikimin e shpenzimeve me fonde të veta bazuar në funksionet e qeverisjes (klasifikimi COFOG), rezulton se në vitin 2019, shpenzimet në funksionin *çështjet ekonomike*, ku përfshihen ndër të tjera shpenzimet për transportin, bujqësinë, pyjet, peshkimin dhe gjuetinë, rezultojnë të jenë rritur ndjeshëm duke regjistruar një nivel prej rreth 13.4 miliardë lekë në periudhën e konsideruar nga rreth 9.9 miliardë lekë që ishin në vitin 2018 (në rritje me rreth 33.9% në terma vjetorë). Brenda këtij funksioni, rreth 11.3 miliardë lekë (+47.2%) u shpenzuan në nën-funksionin e *transportit*, i cili përmbledh shpenzimet në funksion të ndërtimit, rehabilitimit dhe të mirëmbajtjes së rrugëve (përfshirë sinjalistikën) dhe transportin publik.

Gjatë vitit 2019, rreth 21.5% e burimeve financiare totale ose rreth 12 miliardë lekë u shpenzuan në funksionin *strehimi dhe komoditetet e komunitetit* (+2.1% në terma vjetorë). Ndër vite, vihet re përqendrim i shpenzimeve të bashkive në këtë funksion dhe një rritje progresive, pasi ngushtësisht i lidhur me infrastruktura vendore të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në jetën e komunitetit. Brenda këtij funksioni, rreth 10.3 miliardë lekë u shpenzuan në nën-funksionin e zhvillimit të komunitetit (+2% krahasuar me një vit më parë), i cili përmban veprimtari që synojnë përmirësimin e kontekstit të jetesës, si rekreacioni, përmirësimi i hapësirave të përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin, përmirësimi i hapësirave të gjelbra, mirëmbajtja e trotuareve, parqeve, lulishteve, etj. Diferenca prej rreth 1.7 miliardë lekësh u shpenzua për nën-funksionet e urbanistikës vendore, furnizimit me ujë dhe të ndriçimit rrugor.

Grafik 41. Prirja e shpenzimeve kapitale me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet për *funksionin e arsimit* shënuan një nivel prej rreth 10.8 miliardë lekë, në rritje vjetore me rreth 17.6% dhe përfaqësuan rreth 19.3% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2019. Zgjerimi progresiv i shpenzimeve në këtë funksion vlerësohet të jetë pasojë e funksioneve të reja të transferuara nga qeverisja qendrore drejt asaj vendore (për pagat e personelit mësimdhënës dhe mbështetës në kopshte dhe çerdhe, dhe personelit mbështetës në arsimin fillor dhe të mesëm; mirëmbajtës së infrastrukturës arsimore në arsimin para-universitar). Duke filluar prej vitit 2016, shpenzimet në këtë funksion janë rritur në mënyrë të ndjeshme dhe progresive nga viti në vit, shpenzime kryesisht të mbuluara nëpërmjet transfertës sektoriale për funksionet e transferuara në vitin 2016. Për vitin 2019, rreth 8.5 miliardë lekë ose rreth 78.7% e shpenzimeve në funksionin e arsimit shkoi për mbulimin e kostove të arsimit parashkollor dhe fillor. Në nën-funksion të arsimit të mesëm u shpenzuan rreth 2.3 miliardë lekë, në rritje me rreth 39.7% në terma vjetorë.
Funksioni i mbrojtjes sociale përthithi rreth 3.8% të shpenzimeve me fonde të veta apo rreth 2.1 miliardë lekë (funksion që përfshin shpenzime për strehimin social, papunësinë, familja dhe fëmijët, të moshuarit, sëmundje dhe paaftësitë). Në terma vjetorë, shpenzimet për mbrojtjen sociale rezultojnë të jenë ngushtuar me rreth 15.7% në terma vjetorë.

Në vitin 2019, në funksionin *rendi dhe siguria publike* u shpenzuan rreth 1.4 miliardë lekë nga vetëm 54.6 milionë lekë të shpenzuara në fund të vitit 2018. Ky funksion përmbledh shpenzime të cilat lidhen me shërbimet policore të nevojshme për ruajtjen e rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike si dhe zbulimin dhe parandalimin e informalitetit në territorin e bashkisë; shërbime të mbrojtjes nga zjarri dhe të mbrojtjes civile; dhe shërbime të nxitjes së marrëdhënieve me komunitetin.

Hapësirë informuese 6

Shpenzimet me fonde të veta: si paraqiten bashkitë?

Bashkitë e formuara në vijim të reformës administrative dhe territoriale paraqesin diferenca të theksuara në terma të shpenzimeve të kryera me fonde të veta, kushtëzuar nga: (i) numri i popullsisë rezidente në territor, si dhe (ii) kapaciteti fiskal i tyre. Për të pastruar të dhënat nga efekti "madhësi" do të marrim në analizë shpenzimet e kryera nga bashkitë me fonde të veta për një banor (shiko shtojcën 1). Transformimi në indekse me bazë 100, lejon për një interpretim të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe evidenton diferencat ndërmjet bashkive në lidhje me kapacitetin për të kryer shpenzime në mënyrë të pavarur.

Të dhënat për frymë për shpenzimet e kryera me fonde të veta vënë në dukje diferenca të theksuara ndërmjet bashkive në mundësitë për të kryer shpenzime me fonde të veta në periudhën e konsideruar. Mesatarisht, një bashki shpenzoi rreth 19,949 lekë për banor në vitin 2019 (indeksi = 100). Niveli maksimal i indeksit për shpenzimet me fonde të veta për frymë shënohet në bashkinë Dropull (indeksi = 244 apo në vlerë me rreth 44,190 lekë për frymë), ndjekura nga bashkia Himarë (indeksi = 232.1 apo në vlerë me rreth 42,009 lekë për frymë). Në skajin tjetër, bashkia Peqin rezulton të ketë regjistruar nivelin më të ulët të shpenzimeve me fondet të veta për frymë (indeksi = 60.9 apo në vlerë me rreth 11,023 lekë për frymë), ndjekur nga bashkitë Kurbin (indeksi = 61.1 apo në vlerë me rreth 11,027 lekë për frymë), Krujë (indeksi = 65 apo në vlerë me rreth 11,759 lekë për frymë), Cërrik (indeksi = 64.1 apo në vlerë me rreth 11,603 lekë për frymë) dhe Belsh (indeksi = 65.4 apo në vlerë me rreth 11,835 lekë për frymë). Në raport ndaj mesatares kombëtare, rreth 45.9% e bashkive (apo 28/61 bashki) kryejnë shpenzime me fonde të veta për frymë mbi mesataren kombëtare. Pjesa tjetër e bashkive qëndron nën mesataren kombëtare në lidhje me treguesin në analizë.

Diferenca e theksuar mes nivelit minimal dhe maksimal të shpenzimeve për frymë me fonde të veta (rreth 1.8 herë më e lartë se mesatarja kombëtare apo rreth 33,167 lekë), sinjalizon për ekzistencën e diferencave të thella në kapacitete fiskale të bashkive dhe nevojën për zbutjen e tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve publike vendore. Si hap fillestar në këtë drejtim vlerësohet të adresohet llogaritja e kapaciteteve fiskale potenciale të bashkive dhe më tej vlerësimi i performancës së tyre kundrejt potencialit. Më tej, treguesi i performancës që lidhet me normën e mbledhjes së të ardhurave mund të faktorizohet në formulën e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, si element për të neutralizuar diferencat për bashkitë që ndodhen në pozicion fiskal jo të favorshëm.

Grafik 42. Indeksi i shpenzimeve me fonde të veta (bashkitë përkundrejt mesatares afatgjatë)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

3.3 | SHPENZIMET E KRYERA ME FONDE NGA TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA

Krahas shpenzimeve me fonde nga burime të veta, bashkitë kryejnë shpenzime edhe me fonde të kushtëzuara (fonde të cilat transferohen nga institucione qendrore, si ministritë e linjës, dhe që duhet të përdoren sipas qëllimit të përcaktuar). Për këtë kategori të hyrash në buxhetin vendor, bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrjeje në sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve: pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, me destinacion të përcaktuar). Këto fonde transferohen nga buxhetet e ministrive të linjës në trajtën e transfertave të kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara dhe/ose projekteve të veçanta të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar ku kërkohet bashkëpunimi me bashkitë. Ato planifikohen në buxhetet vjetore dhe planet buxhetore afatmesme të ministrive përkatëse. Raporti i zbatimit të buxhetit vjetor të ministrisë të linjës përmban një aneks të dedikuar ku paraqiten transfertat e kushtëzuara, qëllimi i përdorimit të tyre, përfituesi, vlera totale, shuma e lëvruar dhe pjesa e mbetur për tu financuar në vitet në vijim për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndonëse të parashikuara dhe të transferuara nga buxhetet e njësive qendrore të qeverisjes (si ministritë e linjës), ato reflektohen në totalin e shpenzimeve të kryera prej bashkive.

Në periudhën 2016-2018, shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara kanë ndjekur prirje rritëse, kryesisht në vijim të ndryshimeve të aplikuara në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë. Pas një ngadalësimi të shënuar në normën e rritjes së shpenzimeve me fonde të kushtëzuara përgjatë vitit 2018, në vitin 2019, shpenzimet në këtë kategori shënuan një nivel prej rreth 29.6 miliardë lekësh, në rënie me rreth 12.6% në terma vjetorë. Ky rezultat është në kontrast të plotë me rritjen dy-shifrore të shënuar në vitin 2017 (+ 26.2% në terma vjetorë).

Grafik 43. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Bazuar në klasifikimin ekomomik, rreth 75.6% e shpenzimeve me fonde të kushtëzuara u përqendrua në mbulimin e shpenzimeve korrente (të cilat janë të përqendruara kryesisht në transfertat për buxhetet familjare - ndihmë ekonomike, pagesa e paaftësisë etj.) dhe rreth 24.4% në mbulimin e shpenzimeve kapitale (investime përfshirë fondet e dhëna nga FZHR-ja). Ndaj totalit të transfertave të kushtëzuara, fondet e alokuara nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale përfaqësojnë rreth 69.6% ndaj totalit ose rreth 20.6 miliardë lekë në fund të vitit 2019 (në rënie të lehtë në terma vjetorë me rreth 2.8%). Në të njëjtën linjë, shpenzimet me fonde të kushtëzuara për investime regjistruan një nivel prej rreth 7.2 miliardë lekë, në rënie të theksuar me rreth 29.6% në terma vjetorë. Në vitin 2019, investimet e kryera me fonde të kushtëzuara u përqendruan kryesisht në funksionet *strehimi dhe komoditetet e komunitetit* (rreth 3.8 miliardë lekë) dhe në arsim (rreth 2.4 miliardë lekë).

Grafik 44. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas natyrës ekonomike



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, 7.1% e fondeve të kushtëzuara për investime u përthithën nga bashkia Tiranë, ndjekur nga bashkitë Durrës (5.7%), Krujë (4.8%) dhe Elbasan (4.3%). Në të kundërt, bashkia Finiq nuk regjistron të ketë ndërmarrë investime me fonde të kushtëzuara. Praktikisht, 22.9% e bashkive përftuan mbi 2% të fondeve të kushtëzuara për investime ndërsa, 27.8% e tyre përftuan nën 1% të fondeve për këtë qëllim.

Grafik 45. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas funksioneve të qeverisjes



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.4 | KOSTO E QEVERISJES VENDORE NË FUND TË VITIT 2019

Në total, 61 bashkitë në vend shpenzuan mesatarisht rreth 30,514 lekë për frymë përgjatë vitit 2019, në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligj. Sipas burimit të financimit, shpenzimet me fonde të veta rezultojnë të jenë rreth 19,949 lekë për frymë (në rritje me rreth 15.7% në terma vjetorë) dhe me fonde të kushtëzuara rreth 10,564 lekë për frymë (-12.6% në terma vjetorë).

Pavarësisht burimit të financimit, në funksion të qeverisjes vendore u shpenzuan rreth 85.4 miliardë lekë[31] në fund të vitit 2019, në rritje me rreth 4.0% në terma vjetorë. Zgjerimi i shpenzimeve në terma vjetorë u përcaktua gjerësisht nga rritja e shpenzimeve me fonde të veta të bashkive. Në terma nominalë, rreth 55.8 miliardë lekë ishin shpenzimet me fonde të veta (+15.7%) dhe rreth 29.6 miliardë lekë ishin shpenzimet me fonde të kushtëzuara (-12.6%). Në të dyja kategoritë e shpenzimeve, me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara, shpenzimet korrente për personelin, operative dhe të tjera kanë peshën kryesore dhe janë përcaktues i kahut të zhvillimeve në shpenzimet vendore. Në të gjithë periudhën e konsideruar, shpenzimet korrente kanë peshë mbizotëruese dhe në rritje nga viti në vit. Në vitin 2019, shpenzimet korrente përfaqësuan rreth 70.9% dhe shpenzimet kapitale rreth 29.1% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2019.

Grafik 46. Përdorimi i burimeve financiare totale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Gjatë vitit 2019, shpenzimet korrente totale shënuan një nivel prej rreth 60.6 miliardë lekë, në rritje me rreth 3.1% në terma vjetorë. Zgjerimi i shpenzimeve korrente u diktua në masë të madhe nga rritja e shpenzimeve të personelit: në vitin 2019 bashkitë shpenzuan rreth 22.4 miliardë lekë për personelin, në rritje me rreth 5.8% në terma vjetorë. Në të njëjtin kah, por në masë më të vogël, kontribuoi, gjithashtu, rritja e shpenzimeve operative dhe të tjera (në këtë kategori peshë të rëndësishme zënë shpenzimet për transfertat në buxhetet familjare, ndihmë ekonomike dhe pagesë paaftësie). Shpenzimet për investime shënuan një nivel prej rreth 24.8 miliardë lekë, duke rezultuar me një rritje prej rreth 6.4% në terma vjetorë.

Hapësirë informuese 7

Shpenzimet e personelit dhe numri i të punësuarve në 61 bashki[32]

Rritja e eficiencës në përdorimin e burimeve njerëzore në kontekstin e ofrimit të shërbimeve publike vijon të mbetet një sfidë për t'u adresuar nga të gjitha vendet. Kjo sfidë bëhet edhe më e rëndësishme sidomos në vendet në zhvillim ku burimet financiare janë të kufizuara dhe për rrjedhojë nuk arrihet të përmbushen nevojat për shërbime publike qoftë në nivel qendror ashtu dhe në atë vendor. Procesi i decentralizimit eci me ritme të përshpejtuara në pesëvjeçarin e fundit, ku ndër të tjera, u zbatua ri-organizimi territorial nga 373 bashki dhe komuna, në 61 bashki të reja. Ngjashëm me ri-organizimin territorial, bashkitë ri-strukturuan edhe burimet njerëzore dhe strukturat organizative të tyre. Analiza e treguesve të kostove të personelit dhe numrit të të punësuarve në bashki, lidhet drejtpërdrejt me një ndër qëllimit e RAT dhe reformave të tjera decentralizuese, atë të rritjes së eficiencës në administrimin e burimeve në dispozicion.[33]

Në vitin 2019, numri total i punonjësve në 61 bashkitë në vend ishte afërsisht 32,213 punonjës. Bashkia Tiranë llogaritet të ketë numrin më të lartë të punësuarve, me rreth 19.6% të të punësuarve total, ndjekur nga bashkia Durrës me rreth 5% të tyre. Në bashkinë Elbasan dhe Fier janë të punësuar respektivisht 4.1% dhe 4% e të punësuarve total në nivel bashkie. Në raport me numrin e të punësuarve mesatar vjetor në sektorin shtetëror,[34] të punësuarit në 61 bashkitë në vend përfaqësuan rreth 18.6% ndaj totalit. Ndërsa, krahasuar me numrin total të punonjësve në qeverisjen qendrore për vitin 2019,[35] të punësuarit në nivel vendor (61 bashki) përfaqësuan rreth 39.1%.

Grafik 47. Shpërndarja e të punësuarve sipas bashkive (numër të punësuar)



Burimi: www.financatvendore.al & Faqe interneti zyrtare të bashkive

Mesatarisht, për 1 punonjës të qeverisjes qendrore u shpenzua rreth 77,027 lekë në muaj, ndërkohë që për 1 punonjës bashkie u shpenzua 58,023 lekë në muaj, rreth 19,007 lekë ose rreth 32.8% më pak.[36] Kosto mesatare për të punësuar paraqet luhatshmëri të ndjeshme ndërmjet 61 bashkive, ku niveli minimal regjistrohet në bashkinë Këlcyrë me rreth 40,646 lekë dhe niveli maksimal regjistrohet në bashkinë Selenicë me rreth 100,080 lekë. Në rreth 36% (ose 22/61 bashki) të bashkive kosto mesatare rezulton të jetë mbi mesataren e llogaritur si psh. në bashkitë Selenicë, Rrogozhinë, Poliçan, Tiranë, Kavajë, Durrës etj.[37]

Analiza në terma nominalë e numrit të të punësuarve dhe kostove mesatare të personelit janë një hap i parë për të vlerësuar mbi ofrimin e shërbimeve publike vendore dhe përdorimin e burimeve financiare në dispozicion. Një tregues i përdorur gjerësisht në literaturë për të vlerësuar mbi nivelin e ofrimit të shërbimeve publike vendore është numri i të punësuarve për 1,000 banorë.[38] Krahasuar me nivelin benchmark të përdorur nga Banka Botërore prej më pak se 25 punonjës për 1,000 banorë, rezulton se 54 bashki kanë një nivel më të ulët se referenca. Në të kundërt, 7/61 bashki qëndrojnë mbi këtë nivel reference, duke sugjeruar për mbi-ngarkesë të punonjësve bashkiakë në raport me popullsinë e bashkisë.[39]

Grafik 48. Të punësuar në bashki për 1,000 banorë



Burimi: www.financatvendore.al & Faqe interneti zyrtare të bashkive

Niveli mesatar i treguesit për 61 bashkitë në vend vlerësohet në rreth 12 punonjës për 1,000 banorë, me një nivel minimal prej rreth 6 të punësuar për 1,000 banorë në bashkinë Kamëz dhe nivel maksimal prej rreth 34 të punësuar për 1,000 banorë në bashkinë Skrapar. Rreth 33/61 bashki në vend rezultojnë të regjistrojnë një nivel të këtij treguesi mbi mesataren kombëtare si bashkitë: Tepelenë (23 punonjës për 1,000 banorë), Përmet (29 punonjës për 1,000 banorë), Kolonjë (28 punonjës për 1,000 banorë), Këlcyrë (30 punonjës për 1,000 banorë), Gjirokastër (22 punonjës për 1,000 banorë), Dropull (27 punonjës për 1,000 banorë), Delvinë (22 punonjës për 1,000 banorë) etj. Në të kundërt, në bashkitë Devoll, Durrës, Elbasan, Krujë, Kurbin, Kamëz, Peqin, Rrogozhinë, Selenicë, Shijak, Shkodër, Ura Vajgurore dhe Vlorë regjistrohet një nivel të punësuarish për 1,000 banorë ndjeshëm nën mesataren kombëtare.

Numri i të punësuarve ndikon drejtpërdrejt dhe rëndon gjerësisht në buxhetet vendore. Nga viti në vit, pesha e shpenzimeve të personelit ndaj shpenzimeve totale paraqet rritje të vazhdueshme, nga rreth 18.5% të shpenzimeve totale në vitin 2015 në rreth 26.2% në vitin 2019.[40] Të dhënat tregojnë për një marrëdhënie të zhdrejtë (korrelacion negativ) midis kostos mesatare për të punësuar dhe numrit të të punësuarve për 1,000 banorë. Ky rezultat sugjeron për një strukturë "të sheshtë" të kostove të personelit duke aplikuar paga të ulëta përkundrejt një numri të lartë të punësuarish. Gjithashtu, diskriminimi i nivelit të pagës varësisht numrit të popullsisë vlerësohet të pengojë përzgjedhjen dhe angazhimin e burimeve njerëzore cilësore në nivel bashkie. Ky problem rezulton të jetë i theksuar për bashkitë të cilat kanë popullsi më të ulët se 100,000 banorë, ku diferencimi në intervalet e pagave thellohet më shumë. Përcaktimet e VKM-së nr. 177/2017, vlerësohet të jenë diskriminuese dhe shkaktojnë zhvendosjen e burimeve njerëzore të kualifikuara drejt bashkive të mëdha me paga më të larta dhe/

ose mund të bëjnë këto bashki jo "tërheqëse" për personel të kualifikuar. Kjo mund të përkthehet në mungesë dhe/ose cilësi të ulët të shërbimeve publike të ofruara nga bashkitë.

Janë rreth 32,213 të punësuar në 61 bashkitë në vend apo rreth 12 të punësuar për 1,000 banorë. Diferencat ndërmjet bashkive janë të theksuara, si në nivel të kostos mesatare për të punësuar ashtu dhe në nivelin e ofrimit të shërbimit vlerësuar nga treguesi i numrit të punësuarve për 1,000 banorë. Të dy këto tregues, ngrenë pikëpyetje mbi nivelin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve nga qeverisja vendore (bashkitë në vend). Kjo e fundit, gërshetuar dhe me mungesën e studimeve të thelluara mbi kostot e ofrimit të shërbimeve publike vendore dhe standardeve përkatëse krijojnë paqartësi dhe nuk mundësojnë për zgjidhje eficiente në terma të sasisë së burimeve njerëzore.

PËRFUNDIME

Bashkitë përfaqësojnë nivelin e qeverisjes më pranë qytetarëve dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetesës së tyre nëpërmjet shërbimeve publike vendore që ato ofrojnë. Roli i tyre në qeverisje vlerësohet të jetë rritur në mënyrë të vazhdueshme në vijim të reformave decentralizuese të ndërmarra në 5-vjeçarin e fundit, të cilat synuan fuqizimin e qeverisjes vendore.

- Të ardhurat nga burimet e veta vendore ndaj PBB-së u vlerësuan në nivelin 1.5% dhe burimet financiare të disponueshme ndaj totalit të të ardhurave të qeverisë së përgjithshme përfaqësuan rreth 3.1% të tyre: të dy këto tregues sugjerojnë për rritje të rolit të qeverisjes vendore përkundrejt asaj të përgjithshme, krahasuar me vitin e mëparshëm.
- Konkretisht, përmirësimi i performancës në kahun e të ardhurave rezulton të jetë përcaktuar nga zgjerimi i hyrave nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe të ardhurat nga burime të veta vendore.
- Megjithatë, ndonëse në pamje të parë qeverisja vendore duket të jetë fuqizuar ashtu si dhe synuar nga reformat e ndërmarra ndër vite, një analizë në detaje sipas zërave dhe sipas bashkive evidenton për dobësi dhe pabarazi të theksuara ndërmjet 61 bashkive në vend.
- Ecuria e të ardhurave nga burime të veta vendore vijon të përcaktohet nga një numër i kufizuar taksash: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe nga të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat; dhe nga performanca në këto zëra e bashkisë Tiranë;
- Natyra ciklike e kësaj takse gërshetuar me përqendrimin e të ardhurave prej saj në bashkinë Tiranë, mund të krijojë probleme në terma afatgjatë. Gjithashtu, mund të ndodhë që në prani të vështirësive financiare, bashkitë të zhvendosin preferencat për likuiditet në terma afatshkurtër, në kurriz të zhvillimit afatgjatë të qëndrueshëm
- Diferencat dhe pabarazitë në kapacitetin fiskal të bashkive vijojnë të jenë të qenësishme, duke kushtëzuar ofrimin (cilësor) të shërbimeve publike vendore dhe përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore (si tërmetet e shtatorit dhe nëntorit 2019).
- Viti 2019 shënoi dy momente të rëndësishme: zgjedhjet vendore të muajit qershor dhe fatkeqësitë natyrore të muajve shtator dhe dhjetor. Këto të fundit, patën pasoja të rënda në jetën e komuniteteve, në jetë njerëzish dhe dëme materiale të mëdha në struktura, pasojat e të cilëve pritet të jenë më të ndjeshme në buxhetet vendore përgjatë vitit 2020.

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën anën tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Rëndësia e qeverisjes vendore në terma të shpenzimeve rezulton të jetë rritur duke filluar prej vitit 2015.

- Treguesi i shpenzimeve të kryera me fonde të veta ndaj PBB-së shënoi rritje nga rreth 2.3% në 3.3% në fund të vitit 2019. Megjithatë, vlen të theksohet se:

- Rritja e shpenzimeve kanalizohet më së shumti në mbulimin e shpenzimeve korrente (personel, operative dhe të tjera) të cilat vijuan prirjen rritëse edhe përgjatë vitit 2019;
- Shpenzimet kapitale gjithashtu shënuan rritje në vitin 2019, por pesha e tyre në totalin e shpenzimeve mbetet e ulët dhe përfaqësuan rreth 1.5% të PBB-së nominale;
- Mesatarisht, 61 bashkitë shpenzuan rreth 30,514 lekë për frymë përgjatë vitit 2019 ndër të cilat, rreth 21,645.2 lekë u përdorën për mbulimin shpenzimeve të personelit, operative dhe të tjera; rreth 8,868.5 lekë u përdorën për investime.

SHTOJCA

Tabelë 4. Shpenzimet me fonde të veta për frymë, në lekë

	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatare 2017-2019	Indeks Mesatare
Belsh	5,287	13,329	14,945	9,894	11,835	12,225	68
Berat	12,836	18,645	14,448	14,550	15,067	14,688	81
Bulqizë	11,644	12,906	12,455	13,648	18,454	14,852	82
Cërrik	6,404	11,846	11,689	10,334	12,786	11,603	64
Delvinë	10,207	25,512	22,789	23,690	21,526	22,668	125
Devoll	5,821	10,856	12,410	12,657	16,677	13,914	77
Dibër	6,358	11,112	14,275	11,150	11,682	12,369	68
Divjakë	10,962	20,791	12,848	11,850	12,879	12,526	69
Dropulli	24,077	40,249	38,513	48,928	45,128	44,190	244
Durrës	13,998	13,816	14,950	12,982	16,520	14,817	82
Elbasan	10,470	13,738	11,832	12,257	13,703	12,597	70
Fier	11,174	16,089	15,157	13,271	14,404	14,277	79
Finiq	12,362	13,555	26,428	31,901	28,847	29,059	161
Fushë Arrëz	11,839	17,424	22,335	33,404	22,950	26,230	145
Gjirokastër	18,138	22,939	21,297	18,689	20,644	20,210	112
Gramsh	9,327	13,378	20,562	17,107	19,329	18,999	105
Has	11,725	15,598	15,105	14,782	15,681	15,189	84
Himarë	39,886	66,237	36,899	45,256	43,874	42,009	232
Kamëz	6,905	8,003	10,797	13,924	15,723	13,481	74
Kavajë	21,925	23,714	16,837	18,235	20,015	18,362	101
Këlcyrë	10,319	25,989	34,787	23,871	23,007	27,221	150
Klos	6,971	9,670	11,845	13,623	15,897	13,788	76
Kolonjë	14,993	24,455	33,893	30,056	22,818	28,922	160
Konispol	8,054	18,013	29,406	16,612	16,818	20,945	116
Korçë	19,344	21,890	25,916	18,812	20,665	21,797	120
Krujë	8,776	10,905	11,615	11,053	12,608	11,759	65
Kuçovë	14,254	10,803	11,786	13,072	13,612	12,824	71
Kukës	7,731	10,313	14,142	12,338	12,753	13,078	72
Kurbin	6,078	7,743	13,839	9,701	9,631	11,057	61

Lezhë	14,897	11,058	13,411	13,326	18,798	15,178	84
Libohovë	13,391	23,981	38,108	34,579	23,614	32,100	177
Librazhd	10,193	15,491	19,251	19,257	18,264	18,924	105
Lushnjë	11,482	12,674	12,372	12,016	13,116	12,501	69
Malësi e Madhe	5,216	12,993	16,725	14,903	17,506	16,378	91
Maliq	5,282	11,252	16,788	14,163	14,173	15,041	83
Mallakastër	9,205	12,821	15,585	16,620	25,662	19,289	107
Mat	12,080	13,665	15,318	13,122	16,343	14,928	82
Memaliaj	13,497	12,014	17,506	17,801	19,341	18,216	101
Mirditë	14,218	18,348	30,729	19,363	18,396	22,829	126
Patos	10,711	14,058	19,826	22,109	20,744	20,893	115
Peqin	5,316	8,515	12,604	9,814	10,650	11,023	61
Përmet	12,971	26,240	28,717	22,132	22,039	24,296	134
Pogradec	7,452	9,050	10,787	12,591	13,475	12,284	68
Poliçan	10,095	19,283	22,352	20,898	16,599	19,950	110
Prrenjas	5,265	7,494	12,894	12,720	10,775	12,129	67
Pukë	17,493	21,698	22,126	21,425	19,878	21,143	117
Pustec	11,180	11,954	17,585	13,749	18,671	16,668	92
Roskovec	8,746	21,442	17,467	22,441	19,137	19,682	109
Rrogozhinë	7,794	15,126	14,383	13,635	13,950	13,989	77
Sarandë	31,087	24,088	25,463	27,915	33,808	29,062	161
Selenicë	11,227	12,929	19,402	23,058	19,520	20,660	114
Shijak	11,990	11,670	13,048	16,046	12,472	13,855	77
Shkodër	7,474	8,309	10,315	11,790	14,590	12,232	68
Skrapar	24,228	36,164	30,662	26,454	21,617	26,244	145
Tepelenë	23,427	26,440	35,912	28,913	22,233	29,019	160
Tiranë	14,820	20,853	23,728	26,987	34,995	28,570	158
Tropojë	11,355	19,122	17,034	17,883	16,253	17,057	94
Ura Vajgurore	6,761	12,133	11,430	15,006	12,572	13,002	72
Vau i Dejës	7,864	10,510	11,432	10,302	21,254	14,329	79
Vlorë	9,258	11,077	16,617	14,683	16,242	15,847	88
Vorë	15,563	23,617	17,937	26,559	24,220	22,905	127
Total	11,736	15,400	17,097	17,245	19,949	18,097	100

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

Tabelë 5. Shpenzimet kapitale me fonde të veta për frymë, në lekë

	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatare 2017-2019	Indeks Mesatare =100
Belsh	1,462	7,262	6,721	1,253	3,400	3,791	66
Berat	5,315	8,801	3,363	2,729	4,087	3,393	59
Bulqizë	6,071	4,625	3,242	3,059	7,100	4,467	77
Cërrik	1,187	4,447	3,374	1,692	3,237	2,768	48
Delvinë	1,167	10,742	6,336	5,766	4,329	5,477	95
Devoll	1,248	3,300	2,848	1,813	4,041	2,901	50
Dibër	1,437	3,863	4,411	2,192	998	2,534	44
Divjakë	6,231	14,256	4,692	2,246	2,707	3,215	56
Dropulli	4,807	14,255	9,318	12,191	11,569	11,026	191
Durrës	7,333	5,757	6,616	3,693	6,102	5,470	95
Elbasan	3,935	5,473	2,273	1,425	2,424	2,041	35
Fier	4,703	7,078	5,216	2,603	3,369	3,729	65
Finiq	1,960	2,087	9,428	10,690	8,313	9,477	164
Fushë Arrëz	2,820	3,300	7,022	11,587	3,153	7,254	126
Gjirokastër	8,688	9,142	6,597	2,145	2,159	3,634	63
Gramsh	1,680	3,198	8,008	4,315	5,976	6,100	106
Has	6,124	6,735	5,018	2,890	3,214	3,707	64
Himarë	20,305	44,825	13,948	14,089	10,683	12,907	223
Kamëz	3,317	3,355	5,741	8,054	9,555	7,783	135
Kavajë	14,030	12,854	3,610	2,807	4,121	3,513	61
Këlcyrë	1,170	16,704	21,431	7,705	3,639	10,925	189
Klos	1,796	2,318	3,111	2,986	3,875	3,324	58
Kolonjë	3,750	9,047	14,785	8,855	1,935	8,525	148
Konispol	448	8,670	17,000	3,495	2,330	7,608	132
Korçë	10,053	9,323	12,236	3,685	4,574	6,832	118
Krujë	3,381	4,343	4,137	2,550	3,916	3,534	61
Kuçovë	7,121	2,524	1,271	1,347	1,936	1,518	26
Kukës	578	1,115	2,705	572	43	1,107	19
Kurbin	1,265	652	5,377	1,266	1,303	2,649	46
Lezhë	7,065	1,756	2,513	451	4,972	2,645	46

Libohovë	2,062	11,614	24,592	18,088	3,330	15,337	266
Librazhd	4,817	7,970	9,853	7,779	5,909	7,847	136
Lushnjë	5,226	4,373	3,061	2,230	2,671	2,654	46
Malësi e Madhe	485	6,720	9,438	6,146	7,375	7,653	133
Maliq	1,218	4,797	8,181	4,771	3,302	5,418	94
Mallakastër	2,545	2,867	6,171	5,437	11,889	7,832	136
Mat	5,592	4,290	3,543	999	2,596	2,379	41
Memaliaj	5,965	2,587	6,784	4,402	4,133	5,107	88
Mirditë	5,516	6,751	17,298	5,337	3,166	8,600	149
Patos	3,326	4,668	8,802	6,117	8,354	7,758	134
Peqin	648	3,012	5,087	1,403	1,477	2,656	46
Përmet	1,987	12,465	13,091	3,436	3,099	6,542	113
Pogradec	1,476	1,254	2,331	3,060	4,292	3,228	56
Poliçan	1,576	7,524	6,829	3,019	967	3,605	62
Prrenjas	484	886	5,018	3,127	1,916	3,353	58
Pukë	7,643	8,404	5,377	4,634	727	3,579	62
Pustec	4,185	2,260	6,425	1,446	2,396	3,423	59
Roskovec	2,591	13,432	8,370	11,190	7,334	8,965	155
Rrogozhinë	947	6,452	3,814	1,827	2,016	2,552	44
Sarandë	14,334	3,652	5,533	6,560	8,710	6,934	120
Selenicë	4,790	4,347	9,732	10,310	6,515	8,852	153
Shijak	7,398	3,481	3,832	5,678	1,809	3,773	65
Shkodër	1,588	696	2,184	2,045	4,373	2,867	50
Skrapar	10,904	18,044	9,294	4,997	725	5,005	87
Tepelenë	13,453	11,887	17,343	9,543	979	9,288	161
Tiranë	5,348	8,499	10,065	9,372	14,437	11,291	195
Tropojë	4,684	9,100	6,085	5,177	2,710	4,657	81
Ura Vajgurore	799	6,441	5,033	7,042	3,987	5,354	93
Vau i Dejës	2,860	5,330	4,969	2,639	11,378	6,328	110
Vlorë	744	1,350	5,176	875	1,818	2,623	45
Vorë	7,598	13,408	7,762	11,207	10,493	9,821	170
Total	**4,517**	**5,958**	**6,368**	**4,670**	**6,290**	**5,776**	**100**

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

Tabelë 6. Të ardhura nga burime të veta vendore për frymë

	2015	2016	2017	2018	2019	Mesatare 2017-2019	Indeks Mesatare = 100
Belsh	969	4,012	2,158	1,880	2,367	2,135	26
Berat	4,449	4,296	5,742	5,128	4,868	5,246	63
Bulqizë	1,192	1,382	1,765	1,371	1,626	1,587	19
Cërrik	2,055	3,611	2,699	2,687	3,137	2,841	34
Delvinë	2,738	6,103	5,808	3,363	3,808	4,326	52
Devoll	1,771	2,406	2,298	2,749	3,978	3,008	36
Dibër	993	1,065	1,103	1,034	1,605	1,247	15
Divjakë	2,105	2,712	2,261	2,847	2,871	2,660	32
Dropulli	10,739	13,810	13,897	12,487	13,742	13,375	160
Durrës	6,712	6,739	7,451	6,948	7,032	7,144	86
Elbasan	3,579	3,849	4,449	4,556	5,270	4,759	57
Fier	3,983	3,638	4,340	5,116	5,556	5,004	60
Finiq	3,107	4,879	5,574	5,782	5,465	5,607	67
Fushë-Arrëz	1,727	2,631	2,627	2,625	2,696	2,649	32
Gjirokastër	4,769	4,854	4,707	5,244	5,696	5,216	62
Gramsh	2,502	1,709	2,239	2,540	2,162	2,314	28
Has	718	716	841	774	757	791	9
Himarë	14,007	20,763	19,770	23,204	31,497	24,824	297
Kamëz	3,921	4,794	5,529	7,509	7,612	6,883	82
Kavajë	5,830	6,926	8,256	9,357	9,633	9,082	109
Këlcyrë	1,803	1,553	1,734	1,903	1,405	1,680	20
Klos	1,038	1,712	1,426	1,672	2,346	1,815	22
Kolonjë	3,363	3,190	3,883	4,417	3,704	4,001	48
Konispol	3,359	5,216	5,142	3,917	3,536	4,198	50
Korçë	5,556	7,221	7,166	7,951	8,512	7,876	94
Krujë	3,118	4,493	3,687	5,353	5,095	4,712	56
Kuçovë	3,210	3,052	4,074	3,776	3,956	3,935	47
Kukës	1,613	1,918	1,695	1,561	2,587	1,948	23
Kurbin	1,232	1,306	1,543	1,337	1,332	1,404	17
Lezhë	4,375	4,281	5,012	6,098	10,204	7,105	85

Libohovë	2,096	3,087	3,210	2,966	2,488	2,888	35
Librazhd	1,896	2,418	2,917	3,345	3,442	3,235	39
Lushnjë	3,372	4,026	3,863	4,020	4,245	4,042	48
Malësi Madhe	1,324	4,180	1,177	1,973	1,847	1,666	20
Maliq	1,323	1,967	2,138	2,922	2,124	2,395	29
Mallakaster	3,915	7,245	7,902	11,564	5,101	8,189	98
Mat	1,803	1,800	2,381	1,924	2,447	2,251	27
Memaliaj	1,292	1,590	1,335	1,020	995	1,117	13
Mirditë	1,222	2,178	1,594	2,424	2,567	2,195	26
Patos	4,454	4,791	4,277	9,257	5,685	6,406	77
Peqin	1,547	1,845	1,482	1,742	2,398	1,874	22
Përmet	3,242	3,841	2,883	3,699	3,623	3,402	41
Pogradec	2,431	3,086	3,677	3,908	4,464	4,016	48
Poliçan	3,287	3,844	3,858	2,916	2,451	3,075	37
Prrenjas	1,566	1,934	1,921	1,975	1,945	1,947	23
Pukë	1,920	2,361	1,670	2,020	1,431	1,707	20
Pustec	975	1,174	1,101	350	1,123	858	10
Roskovec	7,056	8,245	9,265	6,875	9,298	8,479	102
Rrogozhinë	2,996	3,164	3,510	3,906	4,165	3,860	46
Sarandë	11,331	13,223	14,754	15,690	18,882	16,442	197
Selenicë	2,359	3,072	4,072	3,391	4,356	3,940	47
Shijak	5,193	6,111	5,335	4,824	5,518	5,226	63
Shkodër	3,280	3,421	4,156	4,703	4,489	4,449	53
Skrapar	5,421	7,209	6,200	5,320	5,631	5,717	68
Tepelenë	1,997	2,353	4,056	4,091	3,458	3,868	46
Tiranë	8,786	13,023	18,307	23,487	24,915	22,236	266
Tropojë	1,734	4,196	2,055	2,381	2,040	2,159	26
Ura-Vajgurore	2,991	2,794	3,414	4,257	4,361	4,010	48
Vau I Dejës	3,130	3,220	2,426	3,734	3,383	3,181	38
Vlorë	4,128	4,942	5,498	6,359	6,020	5,959	71
Vorë	10,580	13,727	14,766	15,932	15,236	15,311	183
Total	**4,663**	**5,993**	**7,263**	**8,652**	**9,128**	**8,348**	**100**

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

SHËNIME

1. Në këtë platformë ju mund të ndërtoni vetë raportin tuaj për të monitoruar nga burojnë të ardhurat vendore dhe si shpenzohen ato nga bashkia juaj.

2. Shiko: http://www.seecities.eu/seecities.eu/Portals/0/Images/Stories/Pulications/MFSA%20Brochure_Final_Web_PA.pdf?ver=2018-09-10-071023-543U https://www.oecd.org/regional/regional-policy/Subnational-Governments-Around-the-World-%20Part-I.pdf

3. Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

4. Nën këtë emërues të përbashkët u hodhën hapa të rëndësishëm të cilët u materializuan në: ri-organizimin administrativ dhe territorial në 61 bashki (dhe 12 qarqe); miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020 (SNDQV 2015-2020); hartimin dhe miratimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, i cili ndër të tjera transferoi në nivel ekskluziv një sërë funksionesh të reja; miratimin e ligjit të parë që rregullon financat vendore; si dhe një sërë aktesh të tjera nën-ligjore. Objektiv i përbashkët i të gjitha ndërhyrjeve të sipërpërmendura ishte *fuqizimi i qeverisjes vendore për të krijuar kushtet për rritjen e kapaciteteve vendore në ofrimin cilësore të shërbimeve dhe rritjes së eficiencës në administrimin e burimeve në dispozicion*. Zgjerimi i territoreve në administrim, rritja e numrit të popullsisë dhe shtimi i funksioneve në mënyrë simetrike ndërmjet 61 bashkive, përballi këto të fundit me sfida të rëndësishme në terma të paraqitjes të shërbimeve publike vendore, në prani të kufizimeve buxhetore.

5. Me miratimin e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe transferimin e funksioneve të reja në vitin 2016, ato u shoqëruan me faturën financiare përkatëse, ose ndryshe me transfertën specifike për financimin e tyre. Në vitin pasardhës, u miratua Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i cili ndër të tjera përcaktoi dhe stabilizoi përmasën e transfertës së pakushtëzuar për qeverisjen vendore.

6. Llogaritur si mesatare e thjeshtë e vlerave të raportit të të ardhurave nga burime të veta vendore ndaj burimeve financiare totale për periudhën 2010-2018.

7. Në periudhën 2016-2018, të ardhurat nga burime të veta vendore në bashkinë Tiranë u rritën me ritme dyshifrore (mesatarisht +39%) dhe në vitin 2019 me rreth 6.1%.

8. Bazuar në Ligjin nr. 68/2018 "Mbi financat e vetëqeverisjes vendore", në nenin 11, pika 2 citohet se taksa mbi pasurinë e paluajtshme përfshin "taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën
bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to". Në linjë me përcaktimet ligjore, të ardhurat nga taksa mbi kalimin e të drejtave të pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë.

9. Burimi: www.instat.gov.al

10. Programi i rindërtimit – riparimit – restaurimit të strukturave të destinuara për qëllimi banimi në vijim të dëmtimeve si pasojë e fatkeqësisë natyrore (tërmetet), do të jenë të përjashtuara nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

11. Burimi:http://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-p%C3%ABrgjithshme-dhe-rajonale/tregues-sipas-bashkive/#tab2

12. Në bashkinë Kuçovë rezultojnë të jenë dhënë 4 leje ndërtimi në periudhën janar – shtator 2019 sipas të dhënave të INSTAT. Megjithatë, mund të ndodhë që lejet e ndërtimit të dhëna të përfaqësojnë kategori të cilat janë të përjashtuara nga TNI apo pagesa e kësaj takse të jetë zhvendosur në kohë.

13. Rënia progresive e të ardhurave nga kjo taksë vjen në vijim të ndryshimeve në Ligjin nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar sipas të cilit duke filluar nga viti 2016 të gjitha bizneset e vogla me xhiro vjetore nën 5 milionë lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor, ndërkohë që për bizneset e vogla me xhiro vjetore nga 5-8 milionë lekë shkalla tatimore u përgjysmua.

14. Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

15. Burimi: Regjistri i Borxhit 2018T4 https://financa.gov.al/regjistri-i-borxhit/

16. PBB nominale sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Treguesit Fiskal).

17. Të dhëna sipas Census 2011.

18. Në këtë analizë, ky zë u përfshi në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe nuk do të trajtohet si taksë e ndarë.

19. Bazuar në të dhënat fiskale të qeverisë për vitin 2019 u mblodhën rreth 46.1 miliard lekë të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe 2% e tyre apo 922.5 milionë lekë do të duhet të ishte pjesa e ndarë me bashkitë.

20. Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 23, "shuma totale e transfertës së pakushtëzuar, pas përfundimit të periudhës tranzitore të transferimit të funksioneve të reja në nivel vendor, rritet me madhësinë e transfertave specifike që vendoset të përfshihen brenda transfertës së pakushtëzuar" dhe Aneksi 1, Formula e Transfertës së Pakushtëzuar (MoFE).

21. Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

22. Në Shtator të vitit 2017, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë u shkri dhe programet e mbrojtjes sociale i kaluan portofolit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

23. Burimet financiare totale të njësive të vetëqeverisjes vendore përfshijnë: (i) të ardhurat nga burime të veta vendore (taksa, tarifa, të tjera dhe huamarrje), (ii) të ardhura nga transfertat ndërqeveritare ku përfshihen të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike, (iii) të ardhurat nga taksat e ndara, dhe (iv) të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara. Për të evidentuar zhvillimet në vitin korrent, fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm nuk janë përfshirë në totalin e burimeve totale.

24. Kjo shifër përfshin të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku ndër burimet e financimit të bashkive përfshihet edhe kjo kategori dhe nuk përfshin fondet e trashëguara.

25. Transferta specifike deri më tani është trajtuar si transfertë me destinacion, por në buxhetin e vitit 2019 parashikohet të jetë pjesë e transfertës së pakushtëzuar, por e dedikuar për sektorët që synon të financojë.

26. Kjo shifër përfshin të gjitha shpenzimet e kryera nga bashkitë, me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara. Këtu përfshihen edhe shpenzimet e kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm.

27. Përfshin edhe shpenzimet me fonde të trashëguara. Bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, "kursimet" në shpenzime në vitin korrent reflektohen në buxhetin e vitit pasardhës në trajtën e fondeve të trashëguara.

28. Shpenzimet e personelit për funksionet e reja mbulohen me fonde nga transferta sektoriale. Nëse bashkitë duan të performojnë më mirë apo të rritin cilësinë e këtyre shërbimeve, kostot do të duhet të mbulohen me burime të tjera të financiare (si psh. nga të ardhurat e veta të bashkive).

29. Përfshin shpenzime operative, subvencione, transferta dhe interesa.

30. Bazuar në të dhënat për popullsinë sipas Census 2011.

31. Kjo shifër përfshin të gjitha shpenzimet e kryera nga bashkitë, me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara (përfshirë shpenzimet me fonde te trashëguara).

32. Në këtë hapësirë informuese do të paraqitet një përditësim me të dhënat për vitin 2019, i analizës në terma sasiorë të të punësuarve dhe kostove të personelit i publikuar në www.financatvendore.al.

33. Për realizimin e kësaj analize u përdor informacioni mbi numrin e të punësuarve në bashki nga dokumentet e PBA-ve 2019-2021; strukturat organizative të publikuara në faqet zyrtare të bashkive, të dhënat financiare nga www.financatvendore.al dhe të dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MoFE).

34. Sipas INSTAT, të punësuar në sektorin shtetëror ishin rreth 172,745 persona në vitin 2019.

35. Burimi: http://www.financa.gov.al/buxheti-2019-fillestar/

36. Kosto mesatare (paga + sigurime), të dhëna viti 2019. Në këtë llogari konsiderohet vlera totale dhe nuk diferencohet për klasë/kategori, shtesat mbi pagë për vjetërsi pune apo kualifikim.

37. Nisur nga diferenca ekzistuese mbi koston mesatare për 1 të punësuar në bashki, vlen të nënvizohet se intervali i luhatjes së pagave në nivel vendor është i përcaktuar në VKM nr. 177/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore". Bazuar në këtë VKM, për efekte të përcaktimit të pagave për nëpunësit civilë, bashkitë janë grupuar sipas përmasës (në terma të numrit të banorëve) në 6 grupe: (i) Bashkia Tiranë; (ii) Bashki me 200,001 - 400.000 banorë dhe me mbi 400,000 banorë; (iii) Bashki me 100,001 - 200.000 banorë; (iv) Bashki me 50,001 - 100.000 banorë; (v) Bashki me 20,001 - 50.000 banorë; (vi) Bashki me deri në 20.000 banorë. Për këto grupe janë vendosur intervale pagash referuese për pozicione hierarkike nga "Kryetari i Bashkisë" deri tek pozicioni "Specialist" i

kategorisë më të ulët, ku në përgjithësi vërehet një nivel page më e lartë për Grupin 1 të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë duke zbritur gradualisht deri tek Grupi 6 ku futen Bashki që kanë një numër popullsie deri në 20 mijë banorë sikurse është rasti i Bashkisë Këlcyrë me 6,113 banorë . Për një krahasim, mund të konsiderojmë për referencë nivelin "Specialist" me kategori page Klasa III Kategoria B, nivel që mund të ketë dhe numrin më të lartë të punonjësve. Bazuar në parashikimet ligjore, në bashkinë Tiranë niveli i pagës luhatet në intervalin e vlerave 27,000 – 61,000 lekë në muaj (bruto) ndërkohë që në bashkinë Këlcyrë niveli i pagës për të njëjtën emërtesë (por klasifikuar si përgjegjës sektori), luhatet nga 22,500 – 35,900 lekë në muaj (bruto). Qartësisht, intervali i pagave sipas klasave/kategorive i parashikuar për bashkinë Tiranë paraqitet ndjeshëm më i lartë se ai në bashkinë Këlcyrë. Krahasuar me bashkinë Tiranë, kjo diferencë vjen duke u thelluar me uljen e numrit të popullsisë për të gjitha bashkitë nën 100,000 banorë. Kështu, një specialist në fushën e mjedisit, do të paguhej maksimalisht rreth 61,000 lekë në muaj në bashkinë Tiranë dhe maksimalisht rreth 35,900 lekë në bashkinë Këlcyrë. Nëse të gjitha kushtet e tjera do të ishin të barabarta dhe në prani të sjelljeve racionale , kushdo do të zgjidhte të konkurronte për punësim në administratën vendore ku paga do të ishte më e lartë. Për pasojë, bashkitë e vogla ku niveli i pagave vlerësohet të jetë më i ulët diktuar dhe nga parashikimet e VKM-së nr. 177/2017, ekspozohen ndaj rrezikut të pa-mundësisë për të përthithur burime njerëzore të përshtatshme dhe të kualifikuara për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

38. Sipas Bankës Botërore, ky tregues duhet të jetë nën 25 të punësuar për 1,000 banorë. Shiko: Urban Partnership Program (UPP), Improving Local Government Capacity – The experience of Municipal Finances Self-Assessment (MFSA) in South – East Europe, The World Bank, January 2018

39. Në këtë analizë, të dhënat për popullsinë janë ato sipas Census 2011.

40. Në vitin 2016 bashkitë u përballën me transferimin e një sërë funksionesh të reja si: konviktet e arsimit para-universitar; qendrat e shërbimeve sociale; shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi; personeli mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jo mësimor në arsimin para-universitar; rrugët rurale; administrimi i pyjeve; ujitja dhe kullimi. Për më shumë shiko shtojcën nr. 4 të ligjit nr. 130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" mbi funksionet e transferuara në nivel vendor dhe të financuara me transfertë specifike (sektoriale).